

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7734 E hënë 10 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

**A**shtu si rastësisht, fillimisht me një pretendim të vogël, e më pas me katër pretendime, sërish të vogla, po lind një lëvizje e re studentore, e shumëpritur nga të gjithë. Kjo gjë...  
Vijon në faqen 21

Nga SULEJMAN MATO

**Një lëvizje e re studentore me përgjegjësi historike apo...**



Opinion **i** Ditës

**Një strategji e përbashkët qeveri-studentë në këto momente, në rastin më të mirë është dëshirë për dialog dhe në rastin e më të rëndësishëm është sprovë për larje...**  
Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI

**Jo Pons Pilatin me studentët!**



Dita e gjashtë e protestës, të rinjtë përzënë pedagogun

## Rama: Ju pres sot të dialogojmë, studentët: S' hyjmë në negociatë

“Qeveria ka afat deri të martën për të plotësuar kërkesat tona”


Pas protestave dhe vendosmërisë së studentëve për përmbytjen e kërkesave të tyre, kryeministri Rama njoftoi se ditën e hënë do të ketë një dialog për universitetin duke nisur nga ora 11:00. Pas reagimit të studentëve që nuk pranuan negociatë, kryeministri u shpreh se nuk kërkon negociatë, por dialog me ta. Rama...

Në faqen 2-3

## ISH-DREJTORI I ISSH: KRITERE TE FORTA PER PRONESINE REALE TE TOKES

# HOXHA: NDRYSHON SKEMA E SIGURIMIT TE FERMEREVERE

Eksperti: Ja kush është pjesa e fermerëve që janë penalizuar padrejtësisht. Informalitet në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi



(Në foto) Ish zv/drejtori i përgjithshëm i ISSH-së, prof.as.dr. Hasan Hoxha. Foto ilustruese

DITA E 36

**Protesta për 'Unazën', Basha: Arta Marku po mbron aferën, Veliaj: Duhet bashkëpunim**  
Në faqen 4

700 MEDIA ONLINE

**Projektligji për WEB-et, s' do lejohet më kopjimi i lajmeve dhe masa e gjobave**  
Në faqen 6-7

LISTA DHE DATAT

**Kempi, emrat e 253 personave që do të kryejnë kontrollet mjekësore për pension**  
Në faqen 10-11

HISTORIA

**Tenton të djegë dy fëmijët dhe veten, neutralizohet nga policia vlonjati**  
Në faqen 12

### BEDRI ALIMEHMETI: NJE RREFENJE PER TE GJITHE



**"Broadway i Tiranës", si jetohej në rrugën e futbollistëve e nxënësve të "Samit"**  
Në faqen 19


## Kardiokirurgu Memishaj: Simptomat kryesore të sëmundjes që çon në vdekje

# "Si të trajtoni zgjerimin e enës kryesore të gjakut"

Ylli Merja: Përdorni rignonin e bardhë për trajtimin e mykut

Nga VOLTIZA DURO

Duhanpirja dhe kequshqyerja janë disa prej faktorëve të rrezikshëm që mund të shkaktojnë një sërë sëmundjesh në organizmin e njeriut. Me kalimin e moshës, mund të shfaqet zgjerimi i pjesës së poshtme të enës krye-



sore të gjakut që e shpërndan atë në të gjithë trupin. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare" kardiokirurgu Sabian Memishaj tregon të gjithë shkaqet e sëmundjes që njihet si aneurizëm abdominal dhe pasojat...

Suplement

Në faqen 12

## PROTESTA E STUDENTEVE KERKESAT



VASILI:

### RAMA QEN RRUGE

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, ka sulmuar ashpër kryeministrin Edi Rama duke e cilësuar atë si qen rruge me antimitingjet që organizon. "Rama me antimitingje si qeni i rrugës me llamarinë lidhur për bishiti. Studentet kanë vënë në një provë ekzistence dhe morali të gjithë shoqërinë, ndërsa Ramën e Co në bankën e të akuzuarit. Kambana të forta po bien në një Shqipëri që do të ndryshojë" shkruan Vasili.

"Studentët pa qeverinë dhe anasjelltas nuk bëjnë asgjë"

# Kryeministri: Dialog për universitetin duke nisur nga sot ora 11:00

Pas protestave dhe ven dosmërisë së studentëve për përmeshjen e kërkesave të tyre, kryeministri Rama njoftoi se ditën e hënë do të ketë një dialog për universitetin duke nisur nga ora 11:00. Pas reagimit të studentëve që nuk pranuan negociatën, kryeministri u shpreh se nuk kërkon negociatën, por dialog me ta. Rama në fjalën e tij theksoi se duhet një strategji e përbashkët mes qeverisë dhe studentëve, ndërsa theksoi se kjo strategji do t'i hapte rrugën përmirësimit dhe zgjidhjes të probleme të arsimit të lartë. "Problemet e arsimit të lartë nuk janë të reja dhe të panjohura. Nevoja për më shumë financim, kushte sociale në tërësi është e ditur. Dua ta them qartë se: as ulja e tarifave, as problemet e tjera, nuk adresojnë sëmundjet, por thjesht simptomat e saj. Duhet të bëjmë shumë më shumë akoma. Unë nuk dua që ata të shpërndahen me një fitore prej lëmshi. Kjo e imja nuk është taktikë, por një bindje se pikërisht tani duhet hartuar një strategji studentët-qeveri, por edhe me ata pedagogë, që duhet të dalin nga rrethi vicioz. Studentët pa qeverinë dhe anasjelltas nuk bëjnë asgjë", theksoi Rama. Mes tjerash duke paralajmëruar për ditën e nesërme një dialog më të gjërë përmes platformës online, shefi i ekzekutivit përsëriti faktin se si qeveria ashtu edhe studentët nuk janë të pa mëkatueshëm, por as pa kusure në të gjithë këtë histori. "Të kuptohemi mirë, studentët



Kryeministri Edi Rama

### RAMA

"Problemet e arsimit të lartë nuk janë të reja dhe të panjohura. Nevoja për më shumë financim, kushte sociale në tërësi është e ditur. Dua ta them qartë se: as ulja e tarifave, as problemet e tjera, nuk adresojnë sëmundjet, por thjesht simptomat e saj. Duhet të bëjmë shumë më shumë akoma. Unë nuk dua që ata të shpërndahen me një fitore prej lëmshi".



### ISH-KRYEMINISTRI SALI BERISHA

Duke iu referuar denoncimeve me emra të studentëve për pedagogët që marrin rryshfet, Berisha thekson faktin se profesori Thanas Xhillari, ish-bashkëshorti i Linda Ramës, është futur nga kryeministri Rama në disa borde.

## Tritan Shehu: Z.Rama, çfarë ju shtyu për të lënë vendin në këto momente

Deputeti i PD, Tritan Shehu thotë se kryeministri Edi Rama duhet të sqarojë se ku ndodhjet në këto ditë protestash dhe arsytet se pse ka udhëtuar. Duke iu referuar vizitës së Ramës në Turqi si dhe takimit me Erdogan, Tritan Shehu shprehet se Rama është i detyruar të bëjë publike çfarë e shtyu kaq fort për të lënë vendin në këto momente. "A mundet që Kryeministri të mjeçullojë me një foto të sotme nga Lezha lajmin e djeshëm për largimin e tij nga vendi, dhe ai i sho-



qëruar po me foto?! Kryeministri duhet të sqarojë se ku ndodhjet në këto ditë protestash mbarë popullore në vend, veçanërisht kjo

mbas atij lajmi pothuajse zyrtar. N.q.s. ka udhëtuar pikërisht këto ditë duhet të sqarojë "pse". N.q.s. atij do t'i duhet të këshillojë për

çfarë po ndodh në Shqipëri, këtë duhet ta bëjë liderët e personalitetet e Perëndimit dhe BE ku ne aspirojmë të shkojmë e standardet e të cilëve duhet të implem-

### “ SHEHU

"Rama është i detyruar të bëjë publike çfarë e shtyu kaq fort për të lënë vendin në këto momente. A mundet që Kryeministri të mjeçullojë me një foto të sotme nga Lezha lajmin e djeshëm për largimin e tij nga vendi, dhe ai i shoqëruar po me foto?"

tojmë. N.q.s. në atë drejtim i janë "mbyllur dyert", kjo është tragjike. N.q.s. ka udhëtuar për shkaqe të tjera, është i detyruar të bëjë publike çfarë e shtyu kaq fort për të lënë vendin në këto momente, kur çdo drejtues tjetër perëndimor në një rast të tillë do të ishte a do të kthehej në zyrën e tij. Së paku duhet të sqarojë zyrtarisht opinionin për të vërtetën dhe jo me një foto të hedhur....", shkruan Shehu.

dhe forcat e shëndetshme akademike nuk janë pa mëkate. As qeveria nuk është pa kusure, mua as nuk më shkon mendjen se qeveria duhet ta lë pas këtë duke

kaluar lumin me uljen e tarifave e pastaj për ti bënë nafen kalit. Të rrimë shtrembër sa të duam, por të flasim drejt. Për mua që ta dini se është e lehtë të kërkoj në

qeveri një manovër taktike, por për hir të së vërtetës që studentët duhet të flasin përmes një përfaqësie, kjo është pak e çuditshme që s'po ndodh. Adresimi i disa

kërkesave financiare-logjistike nuk do të luante ujën e ndenjur" tha Rama. Do të kemi mundësi të komunikojmë këtu nesër (sot) live në mejdanin social. Protes-

ta s'është politike, por po i shpëton hijenave. O bashkë sot dhe për nesër. Ju pres të gjithëve, edhe pa dallim edhe atyre të ngelsave", shtoi kryeministri në ftesën e tij.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokhina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotaktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123, Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk





**PROTESTA**

**SHKODRA NË TIRANË**

Protestës i janë bashkuar edhe studentët e universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" të cilët kanë vendosur që ditën e diel të mos protestojnë në Shkodër por t'i bashkohen protestës së studentëve në Tiranë. Studentët kanë edhe mbështetjen e qytetarëve dhe janë pritur me duartrokitje.



**SOLIDARIZIMI**

**BASHKOHEN GJIROKASTRITËT**

Studentët e Gjirokastrës janë bërë pjesë e protestave studentore në vend, ndonëse i janë bashkuar kësaj proteste vetëm në ditën e gjashtë të saj. Ata kanë mbështetur protestën e studentëve në Tiranë me parulla të tilla si "Tirana jemi me ju", "Bashkimi bën fuqinë" apo "Mos na provokoni" ata e kanë zhvendosur protestën e tyre nga universiteti në rrugën kryesore të pjesës së poshtme të qytetit.



Dita e gjashtë e protestës, nesër mbaron ultimatum i të rinjve

# Studentët 'shpërthejnë' në kor: 'jo' negociata, plotësoni kërkesat

*Shkresa për shefin e qeverisë dhe kreun e Kuvendit*

**Ë**shtë shoqëruar me tensione dhe përplasje protesta e studentëve para Ministrisë së Arsimit gjatë ditës së diel. Teksa pedagogu Jani Marka ka tentuar të marrë fjalën, studentët i kanë marrë megafonin dhe e kanë larguar me forcë pasi sipas tyre është pjesë e 'Lëvizjes për Universitetin' të cilën ata e konsiderojnë si lëvizje politike. "Po tentojnë të na përçajjnë. Ne duam të plotësohen kërkesat tona. Kaq duam. Pedagogu është përfaqësues i lëvizjes komuniste. Larg politika. Nuk duam përçarës në protestë"- thanë studentët. Gjatë një prononcimi për "BalkanWeb", pedagogu Jani Marka tha se ai është goditur me grushte nga një grup që sipas tij është i dhunshëm. "U godita me grushte. U ushtrua dhunë ndaj nesh. Janë dhunuar edhe aktivistët tona. Unë doja të flisja kundër dhunës dhe në atë moment... Imagjino mund të ushtrojnë studentët dhunë? Ne pedagogë dhe studentë jemi bashkë. Kam vite që protestoj për të drejtat e studenteve dhe universitetit. Do shikoni kush janë njerëzit dhe ata që marrin zjarr këtu. Më larguan sepse janë të dhunshëm. PD të tërheqë eksponentët e dhunshëm nga protesta. Jam me studentët, nuk kam lidhje me politikën. Një grup i dhunshëm ka zaptuar protestën. KAUZA e pedagogëve e për-bashkët me studentët. Bëj thirrje që të mos ketë dhunë. Na akuzojnë për përçarje, por do ta merrni vesh ku janë. Forumet partiake po përçajjnë protestën, por ne do i demaskojmë. Janë këtu forumet e tyre, partitë"- tha pedagogu pasi e larguan me forcë.



Protesta e studentëve

**KËSHILLI STUDENTOR**

Këshilli Studentor ka reaguar përmes një deklarate pas tensioneve dhe largimit me forcë të pedagogut Jani Marka nga protesta e studenteve tek Ministria e Arsimit. Këshilli Studentor thotë se dënon dhunën dhe se pedagogu është larguar, pasi është anëtar i një organizate me orientim politik. Këshilli Studentor shprehet se kërkon plotësimin e kushteve të studenteve dhe asnjë ndikim politik.

**KËRKESA E PLOTË E STUDENTËVE**

- DREJTUAR:** Ministrisë së Arsimit dhe Sportit  
**Ministres** së Arsimit dhe Sportit znj. Lindita Nikolla  
**LËNDA:** Kthim përgjigje me shkresë zyrtare
1. Përgjysmim i tarifës së studimi
  2. Rritja nga 10% në 50% e peshës totale të votës së studentëve për të zgjedhur kandidatët për dekan/rektor dhe rritja e përfaqësimit të studentëve në senatin akademik me 20%.
  3. Mbështetur në nenin 99 mbi Këshillat Studentore, Ligji i Arsimit të Lartë pika 2 kërkojmë që Bordi i Administrimit të IAL-ve të ketë numër të barabartë votash si nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe IAL-të dhe të shtohet një përfaqësues në këtë bord nga studentët.
  4. Mbështetje e studentëve për kërkime shkencore.
  5. Mbështetje e studentëve të doktoraturës me fonde për kërkimin shkencor.
  6. Përmirësim i kushteve të konvikteve të universiteteve.
  7. Dyfishim i buxhetit për arsimin e lartë.
  8. Pajisja e të gjithë studentëve me kartën e Studentit brenda vitit akademik 2018-2019.
- Presim përgjigje zyrtare me shkrim deri në orën 14:00. Kërkesa drejtohet nga Këshilli Studentor.*

**Jani Marka: U godita me grushte, janë dhunuar dhe aktivistët**

## Pedagogu rrëmben megafonin, studentët e largojnë me forcë

**Ë**shtë shoqëruar me tensione dhe përplasje protesta e studentëve para Ministrisë së Arsimit gjatë ditës së diel. Teksa pedagogu Jani Marka ka tentuar të marrë fjalën, studentët i kanë marrë megafonin dhe e kanë larguar me forcë pasi sipas tyre është pjesë e 'Lëvizjes për Universitetin' të cilën ata e konsiderojnë si lëvizje politike. "Po tentojnë të na përçajjnë. Ne duam të plotësohen kërkesat tona. Kaq duam. Pedagogu është përfaqësues i lëvizjes komuniste. Larg politika. Nuk duam përçarës në protestë"- thanë studentët. Gjatë një prononcimi për "BalkanWeb", pedagogu Jani Marka tha se ai është goditur me grushte nga një grup që sipas tij është i dhunshëm. "U godita me grushte. U ushtrua dhunë ndaj nesh. Janë dhunuar edhe aktivistët tona. Unë doja të flisja



kundër dhunës dhe në atë moment... Imagjino mund të ushtrojnë studentët dhunë? Ne pedagogë dhe studentë jemi bashkë. Kam vite që protestoj për të drejtat e studenteve dhe universitetit. Do shikoni kush janë njerëzit dhe ata që marrin zjarr këtu. Më larguan sepse janë të dhunshëm. PD të tërheqë eksponentët e dhunshëm nga protesta. Jam me studentët, nuk kam lidhje me politikën. Një grup i dhunshëm ka zaptuar protestën. KAUZA e pedagogëve e për-bashkët me studentët. Bëj thirrje që të mos ketë dhunë. Na akuzojnë për përçarje, por do ta merrni vesh ku janë. Forumet partiake po përçajjnë protestën, por ne do i demaskojmë. Janë këtu forumet e tyre, partitë"- tha pedagogu pasi e larguan me forcë. Vetë studentët e kanë mbështetur deklaratën e mësipërme të pedagogut Jani Marka dhe theksojnë se ai është dhunuar nga persona të cilët janë anëtarë të Partisë Demokratike.

## UNAZA E MADHE REZISTENCA

### Unaza, kryebashkiaku Veliaj: Na duhet bashkëpunim për të ardhmen e Tiranës



kryeqytetit mbështetje për projektet publike. "Thirrja ime për të gjithë qytetarët është: Na duhet bashkëpunimin, na duhet energji pozitive, inkurajim për çdo projekt publik. Ndaj, edhe jam i lumtur që edhe 100 metra më poshtë ku ka filluar projekti i Unazës, kemi një bashkëpunim total nga qytetarët, si nga tepelenasit, si nga tropojanët, si nga korçarët, si nga kuksianët. Fakti që të

gjithë kemi kuptuar se pavarësisht se çfarë ka ndodhur në 20 apo 30 vitet e fundit, e ardhmja e Tiranës varet vetëm nga bashkëpunimi ynë, ky është një lajm shumë i mirë", deklaroi Veliaj. Ministria e Transporteve dhe Bashkia e Tiranës kanë parashikuar që të prishin mbi 120 ndërtime pa leje vetëm në segmentin nga Pallati me Shigjeta deri te Dogana, ndërsa kanë ofruar dëmshpërblim të plotë për ata që i kanë ndërtime me leje dhe banesa sociale e bonus qiraje për ata që i kanë pa leje.



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, gjatë protestës së djeshme

Banorët e Astirit kundërshtuan sërish projektin që i prish shtëpitë

## Dita e 36 e protestës, Basha: Arta Marku po mbron aferën korruptive

"Kush e ka fuqinë politike për një aferë të tillë?"

Banorët e zonës së Astirit janë të vendosur për t'i shkuar deri në fund protestës së tyre kundër prishjes së shtëpive dhe objekteve të tjera që preken nga projekti i zgjerimit të Unazës së Madhe në segmentin nga Pallati me Shigjeta deri te Dogana. Ashtu si edhe më parë, edhe dje për të 36 ditë me radhë të veshur me jelekë portokalli ata kanë dalë në rrugë, duke kërkuar dëmshpërblim në masën 100 për qind për të gjitha ndërtime që do të prishi në këtë të dyja krahë e këtij aksi. Me thirrjet "Shtëpia jonë, gjaku jonë", "Poshtë qeveria", "Do të të rrezojmë në dhjetor, o Edvin kryehorr", "Qeveria e krimi", "Poshtë projekti", etj., banorët e Astirit kanë bërë thirrje për rezistencë deri sa qeveria të dorëzohet dhe të pranohet kërkesat e tyre. Pjesë e protestës së tyre është bërë edhe kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, i cili duke mbështetur kërkesat e protestuesve, denoncoi edhe një herë skandalin e zbuluar nga emisioni "Të Paekspozuarit" që transmetohet në News24, dhe ku u faktua se një prej kompanive që ka fituar tenderin për ndërtimin e lotit të parë të kësaj rruge ka falsifikuar dokumentacionin, përfshi edhe firmën e Sekretarit amerikan të Shtetit, Delaware. Ai theksoi se është e pajustifikueshme që ende nuk ka një prononcim nga autoritetet shqiptare për sa i takon projektin "Unaza e Madhe", që e cilëson si një "aferë korruptive".



Protesta e djeshme e banorëve të Astirit

Basha vijoi të insistojë se projekti "Unaza e Madhe" është një skemë pastrimi parash dhe se forca e tij politike do t'i mbështesë deri në fund banorët e "Unazës së Re" në kauzën e tyre. Sikurse një ditë më parë, ai kërkoi edhe dje arrestimin e kryeministrit Edi Rama, ministrit të Energjetikës dhe Infras-

strukturës Damian Gjikonuri, kreut të ARRSH-së Afrim Qëndro dhe të të gjithë atyre që sipas tij janë përfshirë në këtë aferë korruptive. "Investigimi i medias dhe autoriteteve amerikane provuan falsifikimin e dokumenteve për projektin 40 milionë. Arta Marku mbron këtë aferë korruptive. Arta

Marku e emëruar nga Rama, po mbron personin e kësaj afere. Edi Rama është ulur këmbëkryq me Saillarin, Viktoria Invest dhe Biba x për të ndarë miliona euro. Por, prokuroria nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të marrë në pyetje pronarët e kompanive. Sot dua të shtroj pyetjen para shqiptarëve, kush e ka fuqinë politike në këtë vend në një aferë ku përfshihet ARRSH, në krye të së cilit qëndron personi më i besueshëm i Ramës, Afrim Qëndro? Kemi të bëjmë me një projekt vjedhje. Këtu nuk ka projekt investimesh, por është plan vjedhesh. Sot Shqipëria është në këmbë dhe "Unaza" është në këmbë. Është e njëjta skemë e Teatrit Kombëtar", tha Basha. Ndërkohë që banorët theksuan se protesta e tyre ishte për të mbrojtur pasuritë e tyre, ndërsa paralajmëruan edhe kompanitë që kanë afruar makineritë e rënda në këtë zonë që të largohen. "Është detyrë e të gjithë qytetarëve që t'i bëjnë rezistencë krimi, për të ardhmen e fëmijëve tanë dhe për të ardhmen e popullit", - tha njëra prej banoreve.

### SHKURTE

#### "Unaza e Madhe"/ Banorët e Astirit: Studentët janë shpirti ynë

Banorët e zonës së Astirit kanë dalë në protestë për të kërkuar anulimin e projektit të "Unazës së Madhe", i cili parashikon të shemb shumë banesa. Ata e kanë cilësuar këtë projekt hajdutësh, ndërsa thirrjet e banoreve janë drejtuar edhe kundër kryeministrit Rama duke kërkuar largimin e tij. Gjithashtu, banorët lëshuan thirrje të forta për drejtuesit e makinerive duke i kërcënuar se po afuan makineritë, do t'i djegin me benzinë. Me thirrjen "Shtëpitë do t'i mbrojmë me gjak", protestuesit kanë shprehur mbështetje edhe për studentët, duke i cilësuar ata si shpirti i tyre. "Studentet janë shpirti ynë", thanë ato.

#### Paloka: Çfarë të bëjmë me këta që donin të vidhnin 40 mln euro?

Deputeti i PD, Edi Paloka ka reaguar pas deklaratës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me megaskandalin me tenderin e Unazës së Madhe i denoncuar në emisionin "Të Paekspozuarit" në News24. Gjikonuri u shpreh se nëse konfirmohet falsifikimi i dokumenteve do të zgjidhet kontrata me firmën, por Paloka ironizon përmes një postimi në "Facebook" duke e krahasuar ministrin me një nga personazhet e viteve në '90' që punonte si kamerier në qytetin e Durrësit që tentonte t'ia hidhte klientëve. "Gjikonuri i kapur në flagrancë me skandalin e Unazës së Re deklaroi: "do anulohet tenderin". Pra, 40 milionë euro po e hëngre dhe tani që na kapet thjesht "po anulohet tenderin...". Ai kamerieri, një natë qëlloi me disa klientë që nuk hanin as hilen e as shakanë dhe pasi e rrahën mirë e hodhën dhe në det. Po me këtë "Guru"-n që donte të vidhte me një dorë 40 milionë euro çfarë duhet të bëjmë? Po me këta që kanë 5 vjet që na vjedhin?", shkroi Paloka.

### PROKURORJA

"Arta Marku mbron këtë aferë korruptive. Arta Marku e emëruar nga Rama, po mbron personin e kësaj afere. Edi Rama është ulur këmbëkryq me Saillarin, Viktoria Invest dhe Biba x për të ndarë miliona euro. Por, prokuroria nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të marrë në pyetje pronarët e kompanive"





Kontrolli i politikanëve, mazhoranca dhe opozita me dy mendime në seancë plenare

# Zbulohen raportet e PS dhe PD për vetingun në politikë

"Vetingu i ri ngushtë kostumit të politikanit"

Në seancën e fundit për këtë sesion parlamentar që do të mbahet në datën 20 dhjetor, Kuvendi pritet të marrë në shqyrtim dhe të votojë në seancë plenare edhe nismën e një grupi deputetësh të Partisë Demokratike për vetingun e politikanëve. Por, përveçse ky moment pritet të kthejë opozitën në parlament duke shpëtuar në këtë mënyrë edhe mandatet e tyre nga djegia, kjo seancë plenare nuk do të sjellë asgjë të re për fatin e nismës ligjore për vetingun në politikë. Kjo pasi tashmë mazhoranca ka vendosur ta rrezojë këtë nismë si në kundërshtim me normat kushtetuese dhe konventën e të drejtave të njeriut, pavarësisht se opozita këmbëngul në nevojën e miratimit të saj si hapi i vetëm për të pastruar politikën nga krimi. Në pamundësi për të gjetur konsensus për këtë nismë në Këshillin e Rregullores, mazhoranca dhe opozita kanë vendosur që të shkojnë në seancë plenare me dy raporte, një të hartuar nga relatorja socialiste, Vasilika Hysi dhe një nga relatori demokrat, Oerd Bylykbashi.



Gjatë një seance parlamentare



**VASILIKA HYSI**  
"Në rrethana kur nuk është parashikuar në projektligj një mekanizëm institucional që do të bëjë vetingun e politikanëve dhe nuk mendojmë se mund të ketë një të tillë që arrin qëllimin e synuar nga nisma për ndryshime kushtetuese, i vetmi organ që mund ta bëjë atë është sistemi gjyqësor"

**OPOZITA**  
"Kjo masë është veçanërisht e nevojshme dhe legjitime, po të mbahet në konsideratë fakti se Shqipëria aplikon një sistem elektorral me lista të mbyllur, që i pamundëson votuesit që të lërë jashtë institucionit kandidatin që identifikon se ka lidhje me krimin e organizuar"



**OERD BYLYKBASHI**  
"Qëllimi i këtyre kufizimeve ka për synim mbrojtjen e funksionimit demokratik të institucioneve nga ndikimi i krimi të organizuar. Është interes i lartë publik që politikbërja dhe vendimmarrja të imunizohen nga ky ndikim"



## Ndryshimet në ligj, LSI: Shqipëria në prag të 'juntës ushtarake'

Pavarësisht se ushtria është e ndarë nga policia, ushtarakët mund të bëhen pjesë e forcave të rendit. Ministria e Brendshme ka hartuar disa ndryshime ligjore në ligjin "Për Policinë e Shtetit" ku ndër të tjera parashikon që "për nevojë të veçanta mund të pranohen në Policinë e Shtetit, ushtarakë të Forcave të Armatosura dhe këto pranime do të bëhen me marrëveshje mes dy ministrave atij të Mbrojtjes dhe të Brendshëm". Një parashikim ky që sipas Lëvizjes Socialiste për Integrim krijon mundësinë që në të ardhmen Shqipëria të drejtohet nga një Juntë Ushtarake. Denoncimi është bërë nga kryetari i Komisionit të Sigurisë në Lëvizjen Socialiste për Integrim, Flamur Çela, i cili e quan këtë propozim të ministrit Lleshi si të pabesueshëm për një vend demokrat si Shqipëria. "Mund të duket e pabesueshme, por projektligji famëqar për ndryshime në ligjin e Policisë së Shtetit, i propozuar nga ministri Lleshi duket si ëndërr e keqe që mund të bëhet realitet në kushtet e një mazhorance homogene dhe një kryeministri arrogant. Vendosja e nenit 40/1 për zëvendësimin e trupës së lartë policore me kuadro ushtarë është sa skandalozë aq edhe e frikshme për demokracinë dhe shtetin e së drejtës në Shqipëri. Ky akt i paprecedent tregon regresin në të cilin Shqipëria po rreshtet pasi përfshirja e elementeve me begrund ushtarak bie në kundërshtim me themelin e ligjit për Policinë e Shtetit dhe mënyrën e funksionimit të saj në terren në raporte me komunitetin", shprehej djeg Çela teksta publikoi edhe pjesë të këtij projektligji.

**RAPORTI I SHUMICËS**  
Në raportin e saj prej 27 faqesh, relatorja socialiste, Vasilika Hysi ka bërë një analizë të gjerë të të gjithë nismës ligjore të paraqitur nga deputetët demokrat për vetingun. Ajo thekson se është e qartë se ndërhyrja e propozuar nuk ka marrë parasysh cenimin që i bëhet të drejtës për t'u zgjedhur dhe garancive të parashikuara nga Protokollit 1 të KEDNJ. Sipas saj projektligji cenon reputacionin dhe ndërprerja e mandatit ose ndalimi për kandidim bëhet për shkak të çdo kontakti me persona të përfshirë në krim të organizuar, pavarësisht lidhjeve familjare, kontakteve për shkak të punës ose ushtrimit të funksionit. "Kontakt i parashikuar në projektligj është i vështirë për t'u vërtetuar në çdo rrethanë dhe mund të ketë abuzime gjatë interpretimit dhe zbatimit të tij", - thotë Hysi. Gjithashtu, ajo thekson se konstatohet paqartësi në lidhje me strukturën që do të realizojë vetingun e politikës. "Konstatojmë se propozimi për vetingun në poli-

tikë është "një kostum i ngushtë" për zyrtarët publikë/politikanët, vetingun për të cilët besojmë se duhet ta bëjë drejtësia e reformuar", thuhet në raportin e shumicës.


**RAPORTI I OPOZITËS**  
Në raportin e paraqitur në emër të deputetëve të opozitës, Oerd Bylykbashi

kërkon miratimin e ndryshimeve të propozuar. Sipas tij kjo iniciativë nga pikëpamja e përmbajtjes, përmbush standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare, që garantojnë mirëfunksionimin demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore, institucioneve kushtetuese apo të krijuara

me ligj, nëpërmjet shmangies nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërjeje funksionarëve që kanë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Sipas Bylykbashit Kushtetuta lejon kufizimin me ligj të të drejtave themelore për një interes publik, dhe që nuk cenon thelbin e të drejtës. "Kufizimi me ligj, për një arsye legjitime të demonstrueshme qartë dhe në proporcion me këtë qëllim, i të drejtave të caktuara politike përfshirë atyre zgjedhore, është i pranueshëm në një shoqëri demokratike, si një masë që synon mbrojtjen e sistemit dhe vlerave demokratike dhe institucioneve përkatëse nga influencat kriminale në përzgjedhjen e zyrtarëve, politikbërjen dhe vendimmarrjen", thotë Bylykbashi në raport. Sipas tij deputeti, ministri, dhe drejtuesit apo anëtarët e institucioneve të tjera kushtetuese janë mbajtur të besimit publik, aq sa janë edhe gjyqtarët dhe prokurorët. Në këtë drejtim, thekson ai, marrëdhënia e ngushtë me eksponentët të krimi të organizuar, njëllaj si edhe për rastin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, cenon në themel besimin publik mbi institucionet shtetërore të prekura nga ky fenomen.

## Humbja e trinjakëve në Bulqizë, Çupi: Vdiqën për faj të mjekëve

Deputetja Partisë Demokratike në qarkun Dibër, Dhurata Çupi ka reaguar dy ditë pasi një nënë e re nga Ostreni humbi trinjakët e saj. Deputetja është shprehur se humbja e tre fëmijëve është shumë e rëndë, por sipas saj kjo gjë ka ndodhur pasi në të gjithë qarkun nuk ka asnjë mjek specialist. "Është shumë e rëndë për humbjen e tre foshnjave të nënës 30 vjeçare nga Ostreni. Humbja e tre foshnjave do na vërë në lëvizje të gjithëve. Kjo është një histori që e kam ngritur herë pas here në parlament. Jo vetëm në Bulqizë mungojnë mjekët, por në të gjithë qarkun e Dibërs, mungojnë mjekë specialistë. Por me kryesorja që mjeku i familjes shkon një herë në 3 muaj në të gjitha njësitë e qarkut të Dibërs. Nga kjo qeveri nuk ka investime në qendrat shëndetësore, nuk ka investime në spitale. Kjo është një gjendje alarmi për qarkun e Dibërs, qeveria duhet të marrë masa urgjente duhet të rrisë buxhetin, duhet të sjellë mjekë specialistë në këtë qark. Kjo është një tallje e kësaj qeverisje, mburren që na i sollën mjekët me helikopter nga Tirana, por tre foshnjat humbën për faj të mjekëve", tha Çupi.



# PAKETA ANTISHPIFJE WEBET

Pretendimet e qytetarëve për publikimet do shqyrtohen nga Këshilli i Ankesave

## Projektligji, vërtetësinë e lajmit të portaleve do e përcaktojë AMA

Nuk do lejohet më kopjimi i lajmeve nga të tjerët

Mediat online apo të njohura ndryshe si webe do t'i nënshtrohen një regjimi të rreptë kontrolli për të mospublikuar më lajme të pavërteta apo të kopjuara nga webet e tjera. Qeveria ka hedhur për konsultim drafte dhe parë të projektligjit më anë të të cilit kërkohet të përcaktojë rregullat mbi të cilat duhet të funksionojë media e re online, që ashtu si në gjithë botën, edhe në Shqipëri ka marrë një përhapje të madhe. Në fakt, rregullimi i këtij zhvillimi nuk do të bëhet me një ligj të veçantë, por nëpërmjet ndërhyrjeve në dy ligje ekzistuese dhe më konkretisht në ligjin "Për mediat audiovizive" dhe në ligjin tjetër "Për komunikimet elektronike". Sa i përket ndryshimeve në ligjin e parë ai tashmë me përfshirjen edhe të fushës së mediaeve që funksionojnë nëpërmjet internetit do të ndryshojë edhe titullin dhe do të bëhet "Për mediat audiovizive dhe elektronike", ndërsa përjashtohet nga fusha e zbatimit të tij vetëm media e shkruar. Kështu, drafti i paraqitur parashikon krijimin së pari, të një regjistri të ofruesve të publikimeve elektronike, ku janë të detyruar të regjistrohen të gjitha domenet e webeve me ".al" dhe ato të regjistruara jashtë vendit, si dhe ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike (OSHPE). Sipas kësaj nisme ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik, pra ai që zotëron një web duhet të sigurojë që publikimet të shfaqen në një mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive, të mos cenonjë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos lejojë shfaqjen e publikimeve që mund të nxisin vepra penale. Gjithashtu, një web duhet të respektojë të drejtat e autorit, pra të mos kopjojë lajme nga webet e tjera, si dhe ofrojë një dritare ku mund të bëhet ankesë për lajmin e publikuar. Sipas projektligjit webi është i detyruar të shqyrtojë brenda 24 orëve çdo ankesë të arsyetuar të paraqitur me shkrim nga çdo person për programet e publikuara prej tij. Nëse webi refuzon ankesën, ose nuk kthen përgjigje brenda 24 orësh nga marrja e saj, personi ka të drejtë të ankojë pranë Këshillit të Ankesave, i cili brenda 72 orësh nga depozitimi i ankesës, vendos mbi ankesën përkatese. Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shkelje, merr masat përkatese, duke



**PORTALET**  
Portali publikon konkluzionin e Këshillit të Ankesave, kur ky konkluzion është në favor të personit që ka kryer ankesën, brenda 24 orësh nga marrja e njoftimit, në një mënyrë të njëjtë me atë të realizimit të publikimit, kundrejt të cilit është bërë ankesa.



Gjate një mbledhjeje të qeverisë

### Nga pezullimi 24 orë te mbyllja përfundimtare, ja masat për portalet

Rregullimi i fushës ku do të veprojnë mediat online në Shqipëri nuk do të bëhet vetëm nëpërmjet kërkesës për të bërë përgënjeshtime prej tyre, por edhe me një sërë masash administrative që do të detyrojnë një media të këtij lloji të jetë e vërtetë dhe etike. Kështu për shkeljet e kryera nga ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike, AMA kërkon nga Autoriteti i Komunikimit Elektronik dhe Postar (AKEP) marrjen e masave plotësuese dhe që nisin që nga bllokimi aksesit në internet për një afat 24 orësh, si masë paralajmëruese dhe deri në bllokimin e përhershëm të një webi nëse ai në mënyrë të përsëritur shkel rregullat që përcakton ky projektligj. Më konkretisht për portalet e regjistru-



ara në AKEP  
AMA mund të kërkojë pezullim ose bllokim të aksesit në internet, për një afat 24 orë, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer 3 (tre) kundërvajtje administrative, pezullim ose bllokim të aksesit në internet për një afat 7 (shtatë)-ditor, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer jo më pak se katër kundërvajtje administra-

tive dhe pezullim ose bllokim të aksesit në internet për një afat njëvjeçar, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer jo më pak se 5 kundërvajtje administrative. Akoma të rrepta janë sanksionet për portalet e regjistruara jashtë Shqipërisë. Për të parashikohet bllokimin e aksesit të shërbimit të publikimit elektronik në territorin e Republikës së Shqipërisë, për një afat 24 orësh, nëse nuk marrin në shqyrtim ankesat e përcjella prej Këshillit të Ankesave, më shumë se tre herë gjatë një viti kalendarik dhe bllokimin përfundimtar nëse nuk marrin në shqyrtim ankesat e përcjella prej Këshillit të Ankesave, më shumë se katër herë gjatë një viti kalendarik. Gjithashtu në këtë draft parashikohet që për disa shkelje të vendosen edhe gjoba nga 100 mijë lekë të rinj deri në 1 milion lekë të rinj.

### MASAT QË MERREN NDAJ PORTALEVE

- Për OSHPE-të e regjistruara në AKEP:**
  - Pezullim/bllokim të aksesit në internet, për një afat 24 orë, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer 3 (tre) kundërvajtje administrative të parashikuara nga ky ligj;
  - Pezullim/bllokim të aksesit në internet për një afat 7 (shtatë)-ditor, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer jo më pak se katër kundërvajtje administrative;
  - Pezullim/bllokim të aksesit në internet për një afat njëvjeçar, nëse brenda një viti kalendarik ka kryer jo më pak se 5 (pesë) kundërvajtje administrative të parashikuara nga ky ligj.
- Për ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike që nuk janë të regjistruara në AKEP:**
  - Bllokimi e aksesit të shërbimit të publikimit elektronik në territorin e Republikës së Shqipërisë, për një afat 24 orësh, nëse nuk marrin në shqyrtim ankesat e përcjella prej Këshillit të Ankesave, më shumë se tre herë gjatë një viti kalendarik;
  - Bllokimin përfundimtar/mbylljen e aksesit të shërbimit të publikimit elektronik në territorin e Republikës së Shqipërisë nëse nuk marrin në shqyrtim ankesat e përcjella prej Këshillit të Ankesave, më shumë se katër herë gjatë një viti kalendarik.
- Në rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, sipas neneve 33/1, 51/1 dhe 53/1, të këtij ligji, Këshilli i Ankesave vendos gjobë dhe detyrimin e OSHPE të publikojë fomalën e ndjesjes sipas vendimit përkatesë të shkeljes së konstatuar.
- Kundër vendimit të Këshillit të Ankesave mund të bëhet ankim sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 132, të këtij ligji. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Ankesave.**
- Shkeljet e kryera nga OSHPE-të, kur nuk përbejnë vepër penale janë kundërvajtje administrative dhe dënohen:**
  - Me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë kur nuk respekton detyrimet e nenit 33/1 të këtij ligji;
  - Me gjobë në masën 800 000 (tetëqind mijë) lekë kur nuk respekton vendimin e Këshillit të Ankesave apo të drejtën e përgjigjes, sipas nenit 53/1 të këtij ligji.

përfshirë sanksionet që përcakton ky projektligj. Në çdo rast Këshilli i Ankesave njofton me shkrim personin që ka paraqitur ankesën dhe OSHPE-në përkatese mbi konkluzionin dhe masat. OSHPE-ja, pra portali publikon konkluzionin e Këshillit të Ankesave, kur ky konkluzion është në favor të personit që ka kryer ankesën, brenda 24 orësh nga marrja e njoftimit, në një mënyrë të njëjtë me atë

të realizimit të publikimit, kundrejt të cilit është bërë ankesa. Këshilli i Ankesave, nëse portali nuk reagon për

të përgënjeshtuar lajmin, merr masat përkatese, duke përfshirë sanksionet nga gjobat administrative,

bllokimi i internetit dhe mbyllja e webit. Por ky proces i shqyrtimi të ankesave dhe marrjes së masave

ndaj portaleve shmanë vendimin gjyqësor, duke i dhënë AMA-s rolin e një institucioni thuasje gjyqësor.

**Shoqëria përmbartimore JUSTITIA**  
Shoqëria përmbartimore JUSTITIA shpall ankandrin, faza e dytë, për shlljen e pasurisë së paluajtshme, por të cilat ka vënë hipotekë NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:  
Lloji njësi me sip. 189 m<sup>2</sup> nr.pasurie 5188ind-m1, zk.8350 vol 28 fq146 RR.PMyzeqari TIRANË në pronësi të z.Arjan Rahmi BAHOLLU  
Cmimi me të cilin fillon shllja në ankand është 179.760 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) EUR  
Lloji apartamenti sip.132m<sup>2</sup> zk.8350 nr.pas.5188ind-1-19 vol 28 fq.185 Rruga Prokop Myzeqari TIRANË në pronësi të z.Arjan Rahmi BAHOLLU  
Cmimi me të cilin fillon shllja në ankand është 73.920 (shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzetë) EUR  
Ankandi zhvillohet në datën 08.01.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartuesit gjyqësor, me adresë: Bulevardi Bajram Curri, Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

**Shoqëria përmbartimore JUSTITIA**  
Shoqëria përmbartimore JUSTITIA shpall ankandrin, faza e dytë, për shlljen e pasurisë së paluajtshme por të cilën ka vënë hipotekë NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:  
Lloji pasurisë Ares-Trulli (magazine dy kate) me sip. anë 3000 m<sup>2</sup> (rrall 1661/ndërtesë 234.9, me nr.pasurie 58/9 vol 8 fq.78, zk.1475, Derven, KRUIË në pronësi të z.Haki Ahmet MAVRIQI)  
Cmimi me të cilin fillon shllja në ankand është 67.200 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) EUR  
Ankandi zhvillohet në datën 09.01.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartuesit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi Bajram Curri, Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890





Regjistër i posaçëm për të gjitha mediat online që funksionojnë në Shqipëri

# AKEP do të mbyllë të gjitha web-et që nuk regjistrohen

## Krijohet dhe një bazë të dhënash për çdo web

**T**ë gjitha webet apo portalet që funksionojnë në Shqipëri dhe që janë të hapura brenda apo jashtë vendit do të regjistrohen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike. Në kuadër të paketës antishpifje, qeveria ka parashikuar të bëjë edhe disa ndryshime në ligjin "Për komunikimet elektronike" dhe nëpërmjet të cilave synon të vendosë rregulla për funksionimin e gjithë tregut të mediave online që funksionon në vendin tonë. Ndër ndryshimet që propozohen të bëhen në ligjin në fjalë parashikohet AKEP do jetë institucioni që do të administrojë domenin cc.TLD.al, nënndomenet e tyre dhe gjithçka që ka të bëjë me veprimtarinë e tyre dhe zbatimin e normave ligjore. Për të arritur këtë qëllim AKEP do të krijojë një regjistër të përditësuar, bazë të dhënash (database) për domain nën ".al" dhe nën domain-et ".com.al", ".org.al" dhe ".net.al".



**RREGULLORJA**  
AKEP, nëpërmjet një Rregulloreje të veçantë do të përcaktojë rregullat e detajuara për bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet institucioneve publike, njoftimet dhe zbatimet e vendimeve të KA dhe AMA si dhe në zbatim të parashikimeve specifike të këtij neni.

**RAMA**

"Janë regjistruar më shumë se 20 mijë portale me prapshitesën .al dhe dhjetëra mijëra të tjerë që funksionojnë në gjithë shqipë me prapshitesa të tjera. Nga këto mbi 700 janë portale lajmesh. Deri pak kohë më parë, vetëm 12 menaxhueshin nga struktura redaksionale, dhe 72 nga gazetarë. Të tjerat, më shumë se 600, nuk dihen kush i ka në menaxhim, kush i financon, cilat janë qëllimet e hapjes së tyre"



## Në Shqipëri funksionojnë rreth 700 media online

**N**ë harkun kohor prej 5 viteve të fundit në Shqipëri janë regjistruar rreth 20 mijë portale që kanë marrë domenin .al pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). Ndërsa shumica e tyre janë portale qeveritare apo të bizneseve të ndryshme, 700 prej tyre llogaritet të jenë regjistruar si portale informative mediatike. Këtë të dhënë e konfirmoi pak ditë më parë edhe kryeministri, Edi Rama, i cili, gjithashtu, bëri të ditur një fakt tjetër të rëndësishëm. Sipas tij nga 700 webe, për rreth 600 prej tyre nuk dihet asnjë e dhënë se kush e zotëron". Në 5 vitet e fundit janë regjistruar më shumë se 20 mijë portale me prapshitesën .al dhe dhjetëra mijëra të tjerë që funksionojnë në gjithë shqipë me prapshitesa të tjera. Nga këto mbi 700 janë portale lajmesh. Deri pak kohë më parë, vetëm 12 menaxhueshin nga struktura redaksionale dhe 72 nga gazetarë. Të tjerat, më shumë se 600, nuk dihen kush i ka në menaxhim, kush i financon, cilat janë qëllimet e hapjes së tyre", deklaroi Rama teksa paraqiti para disa ditësh në vija të përgjithshme përmbajtjen e paketës antishpifje.

**PROJEKTLIGJI**

- **NENI 1**  
Në nenin 3, pas pikës 23 shtohet pikat 23/1 dhe 23/2 me këtë përmbajtje:  
"23/1. Ofruesi i shërbimit të publikimeve elektronike" është personi fizik ose juridik, i regjistruar në regjistrin e ofruesve të publikimeve elektronike, që ofron shërbime të publikimit elektronik."  
23/2.1 "Publikimi elektronik" përfshin por nuk kufizohet në program/publikime, përmbajtja e të cilave, nëpërmjet internetit, transmetohet/publikohet në mënyrë ditore ose periodike, nga ofruesit e publikimeve elektronike, me qëllim informimin, argëtimin dhe edukimin e publikut."
- **NENI 2**  
Në nenin 8, shkronja k) dhe shkronja rr) ndryshohen si më poshtë vijon:  
"k) administron domen cc.TLD.al, nënndomenet e tij, si dhe përcakton me rregullore të posaçme rregulla të jashtëzakonshme, si dhe të garantojnë, pagesat, procedurën dhe mënyrën e menaxhimit të këtij shërbimi në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare"  
rr) menaxh masat, që sipërmarrësit e rrjetëve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendje të jashtëzakonshme, si dhe të garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të individit si dhe çdo detyrim të parashikuar në kuadrin ligjor në fuqi në RSH;
- **NENI 3**  
Pas pikës 2 të nenit 12 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:  
"3. AKEP-i bashkëpunon me AMA në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe dispozitave të tjera nënligjore si dhe siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe organeve të tjera të AMA duke detyruar ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet të zbatojnë aktet/vendimet/përkatesë të këtyre autoriteteve sipas afatave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.
- **NENI 4**  
Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:  
"1. AKEP administron një regjistër të përditësuar, bazë të dhënash (database) për domen nën ".al" dhe nën domain-et ".com.al", ".org.al" dhe ".net.al".mil.al", ".edu.al" dhe ".net.al" për të gjithë poseduesit persona fizikë dhe juridikë, të cilët janë të regjistruar në regjistrat tregtarë dhe çdo regjistër tjetër të shtetit shqiptar  
2. AKEP administron një regjistër të përditësuar, bazë të dhënash (database), për domen jo ".mil.al", për të gjithë poseduesit persona fizikë dhe juridikë, ofrues të shërbimeve të publikimeve elektronike, të cilët janë të regjistruar në regjistrat tregtarë dhe çdo regjistër tjetër të shtetit shqiptar.  
3. Të gjitha institucionet, strukturat, organet apo çdo entitet tjetër që administron, mban e menaxhon informacion referuar pikave më sipër në këtë nen, është i detyruar të bashkëpunojë me AKEP për dhënien/marrjen e këtij informacioni të nevojshëm me qëllim mbarevajtjen me efikasitet të këtij procesi.  
4. Me kërkesë të organeve të tatim taksave, apo të çdo organi tjetër të ngarkuar nga legjislacioni, AKEP kryen procedurat deri në mbylljen e domeneve, nëse poseduesit e tyre nuk janë të regjistruar sipas ligjit për ushtrimin e veprimtarisë së tyre ekonomike/regtare që realizojnë përmes domeneve.  
5. Të gjithë poseduesit persona fizikë dhe juridikë të këtij neni, është i detyruar të ".com.al", ".org.al" dhe ".net.al".mil.al", ".edu.al" detyrohen të hapin rubrikën e raportimeve/dërgimit të ankesave për çdo subjekt/palë të interesuar.  
6. KEUP III, të nenit 137, pas pikës 2, shtohet 2/1 me këtë përmbajtje:  
2/1 Nëse ofruesit e shërbimit të komunikimeve publike nuk zbatojnë urdhrat/vendimet e AKEP që lidhen me zbatimin e akteve/vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe të AMA apo të nxjerra nga çdo organ tjetër me kompetenca ligjore në këtë fushë, sipas nenit 4 të këtij ligji.

**Njoftim për shitje me ankand**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e pare të pasurisë të palës debitore Shoqëria "General Polymeren Recycling Albania" sh.p.k, e përbërë nga :

- "ARE", Nr pasurisë 311/3, no Z K Nr. 2255, volum nr.5, faqe 235, me sipërfaqe totale 7033 m2, no Koahs, Durres Ankandi i pasurisë fillon me çmimin filluesitar në masen 163.615, 7 Euro.
- "ARE", Nr. n pasurisë 314, no Z K Nr. 2255, volum nr.1, faqe 212, me sipërfaqe totale 12.900 m2, no Koahs, Durres. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin filluesitar në masen 300.105, 6 Euro.
- "ARE", Nr pasurisë 312, Z Ko Nr. 2255, volum nr.1, faqe 219, me sipërfaqe totale 4.300 m2, no Koahs, Durres. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin filluesitar në masen. 100.035, 2 Euro.

Ankandi do të zhvillohet në datë 24.12.2018 prej orës 15:00 në selinë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Traje. Ofruesit duhet të vërtojnë dokumentacionin të kontaktosojë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-maili [llir\\_devishaj@yahoo.com](mailto:llir_devishaj@yahoo.com) si dhe WEB [www.powerjustice-al.com](http://www.powerjustice-al.com)

**Njoftim për shitje me ankand**

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 567.568 e vijues të K.P.C shqall ankandin e pare për pasurinë e palës debitore Sh"Strati Construction" sh.p.k . K Strati dhe L Strati. Pasuria përbehet nga :

- "Are", Nr. pasurisë 172/2 ndodhur në Draz dhe Durres, Z.K.Nr. 1522, volumi 3, faqe 249, me sipërfaqe totale 1.000 m2, Ankandi fillon me çmimin filluesitar në masen 3.200.000 lekë
- "Apartament", Nr pasurisë 116/1-1-19 në Rrymshocë Kavajë, Z.K.Nr. 2291, volumi 22, faqe 42, me sipërfaqe 33,19 m2.
- "Apartament", Nr pasurisë 116/1-1-20 në Rrymshocë Kavajë, Z.K.Nr. 2291, volumi 23, faqe 43, sipërfaqe 59,24 m2 dhe Ankandi fillon me çmimin filluesitar në masen 2.720.000 lekë

Ankand qendron i hapur 15 ditë dhe do të zhvillohet në datë 24.12.2018 në orën 15:00 në Bulevardin "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Traje. Ofruesit duhet të vërtojnë dokumentacionin të kontaktosojë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-maili [llir\\_devishaj@yahoo.com](mailto:llir_devishaj@yahoo.com) si dhe WEB [www.powerjustice-al.com](http://www.powerjustice-al.com)

it e tyre nuk janë të regjistruar sipas ligjit për ushtrimin e veprimtarisë së tyre ekonomike/tregtare që realizojnë përmes domeneve. Një përcaktim ky që detyron që çdo web apo portal që nuk është hapur në Shqipëri, por funksionon brenda vendit, të regjistrohet dhe të zbatojë të gjitha detyrimet ligjore, përfshi këtu edhe ato që kanë të bëjnë me administratën tatimore. Në të kundërt AKEP në bashkëpunim me institucionet e tjera pasi bën verifikimet përkatëse mund ta mbyllë funksionimin e tij. Ndërkohë që të gjithë poseduesit persona fizikë dhe juridikë, për domen nën ".al" dhe nën domainet ".com.al", ".org.al" dhe ".net.al".mil.al" dhe ".edu.al" detyrohen të hapin rubrikën e raportimeve/dërgimit të ankesave për çdo subjekt/palë të interesuar. Nga ana e tij AKEP, nëpërmjet një Rregulloreje të veçantë do të përcaktojë rregullat e detajuara për bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet institucioneve publike, njoftimet dhe zbatimet e vendimeve të KA dhe AMA si dhe në zbatim të parashikimeve specifike të këtij neni.

## SIGURIMI PËR FERMERËT SKEMA E RE

Ish zv.drejtori i ISSH: Mospagesa në kohë e kontributeve, problem me kamatvonesat

# Ja ku qëndron informaliteti në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi

Hasan Hoxha: Fermerët që janë penalizuar padrejtësisht

Voltiza Duro

Skema aktuale e siguri meve shoqërore për të vetëpunësuarit në bujqësi, është në procesin e ndryshimeve ligjore. Këto ndryshime vijnë me argumentin kryesor, për të ndihmuar përmirësimin financiar të skemës, për lehtësimin e barrës së buxhetit të shtetit, për të rritur interesin për sigurime shoqërore të kësaj kategorie. Në një intervistë ekskluzive për 'Gazeta Shqiptare', ish zv/drejtori i përgjithshëm i ISSH-së, prof.as.dr. Hasan Hoxha tregon se skema aktuale ka pasur një sërë problemesh në zbatimin e kriteveve ligjore. Eksperti thekson se pagesa e kontributeve, me kuotë të diferencuar për rrethet e zonës fushore dhe ato të zonës malore, penalizon padrejtësisht një numër të madh individësh. Më tej Hoxha shton se vjelja e kamatvonesave nuk ka qenë e rregullt, e madje ka pasur raste që një dosje përfitim, të ketë dy lloj vërtetimesh, në varësi të qëllimit të individit për të përfitur.

**Përkundrejt shumë diskutimeve, mund të sillni një opinion tuajin për skemën e sotme për të vetëpunësuarit në bujqësi?**

Edhe pse pjesë e skemës së përgjithshme, për të vetëpunësuarit në bujqësi, skema aktuale e sigurimeve shoqërore, ka natyrë shumë specifike dhe mbart disa veçori. Pa hyrë në të veçantat e saj, pohojmë se kjo skemë mbart karakter social, aq social sa kur krahason përfitimet që jepen, me kontributet e paguara, në përmbajtje ajo merr trajtën e një skeme asistencial. Gjithsesi, ajo ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë mbështetëse për fshatin, një ndihmë për të gjithë, sidomos për të vetëpunësuarit në bujqësi. Për më shumë



Ish zv/drejtori i përgjithshëm i ISSH-së, prof.as.dr. Hasan Hoxha

### SKEMA E TË VETËPUNËSUARIT NE BUJQËSI

Edhe pse pjesë e skemës së përgjithshme, për të vetëpunësuarit në bujqësi, skema aktuale e sigurimeve shoqërore, ka natyrë shumë specifike dhe mbart disa veçori. Pa hyrë në të veçantat e saj, pohojmë se kjo skemë mbart karakter social, aq social sa kur krahason përfitimet që jepen, me kontributet e paguara, në përmbajtje ajo merr trajtën e një skeme asistencial. Gjithsesi, ajo ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë mbështetëse për fshatin, një ndihmë për të gjithë, sidomos për të vetëpunësuarit në bujqësi.

se dy dekada, skema aktuale e të vetëpunësuarve në bujqësi ka shërbyer: për shanse të garantuara në sigurime shoqërore, jo vetëm të forcave aktive të zënë me punë në bujqësi, por dhe të tjerëve që jetojnë në fshat; për plotësimin dhe shtimin me vitet e nevojshme kontributive, krahas atyre të para vitit 1994; për t'u mundësuar ish-kooperativistëve përfshirjen në kategorinë e pensioneve urbane, përmes realizimit, minimalisht të gjysmës së viteve kontributive; për të përfitur trajtime të veçanta apo pensione të parakohshme në bazë të legjislacionit të prodhuar ndër vite. Për shembull, për ish-minatorët, apo kategori të tjera; për të plotësuar vitet kontributive sipas kërkesës

së ligjit për nënat me shumë fëmijë; për të përfitur pagesat për paaftësinë e përkohshme në punë, apo për lejen e lindjes; si dhe për të plotësuar kushtet e tjera ligjore në këmbim të marrjes së përfitimëve të ndryshme. Në anën tjetër, zhvillimi i skemës, përmasat e saj, benifitet e çdo lloji, për pjesën e të vetëpunësuarve në bujqësi, janë realizuar në kushtet e një çmimi shumë të ulët, ndërkohe që, pjesa tjetër e çmimit është përballuar me subvencione nga buxheti i shtetit.

**Thuhet se skema është shoqëruar me probleme në zbatimin e kriteveve ligjore. A mund të flisni më konkretisht?**

Po, shumë probleme ka pasur skema aktuale në

zbatimin e kriteveve ligjore. Sipas gjykimit tim, edhe kjo është një arsye kryesore që e bën të nevojshme ndryshimin e skemës, konceptimin ndryshe të saj. Ashtu siç e gjykoj unë, probleme ligjore të diskutueshme, për skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi, me së pari, janë krijuar qysh në ngritjen e saj. Pagesa e kontributeve, me kuotë të diferencuar për rrethet e zonës fushore dhe ato të zonës malore, për një pjesë të territorit të vendit, përcjell favorin të pajustifikuar, ashtu si pjesa tjetër e tij, penalizohet padrejtësisht.

**Cilat territore të vendit penalizohen padrejtësisht?**

Nëse malësia e Korçës apo e Shkodrës, kontributet vjetore i paguan me një çmim 30 përqind më të lartë, se pjesa tjetër e malësisë në kufi me to, që janë pjesë e rretheve Librazhd, Gramsh apo Pukë e Malësi e Madhe, kjo ndodh pasi Korça dhe Shkodra, sipas përcaktimit ligjor, përfshihen në zonën fushore, ndryshe nga rrethet ngjitur, që janë pjesë e zonës malore. Krahas informalitetit, për të mos hequr formalisht gjendjet civile nga rrethet

### TERRITORET QË PENALIZOHEN

Nëse malësia e Korçës apo e Shkodrës, kontributet vjetore i paguan me një çmim 30 përqind më të lartë, se pjesa tjetër e malësisë në kufi me to, që janë pjesë e rretheve Librazhd, Gramsh apo Pukë e Malësi e Madhe, kjo ndodh pasi Korça dhe Shkodra, sipas përcaktimit ligjor, përfshihen në zonën fushore, ndryshe nga rrethet ngjitur, që janë pjesë e zonës malore.



tare, madje për secilin prej tyre, presupozohet të ketë një dosje të posaçme, por në praktikë zbatimi i këtyre kriteveve vështrohet me rezervë, ato janë shoqëruar me një nivel informaliteti, i cili nuk mund të mos konsiderohet. Ndërkaq zbatimi prej vitesh pa ndryshime i këtyre kriteveve, ka shtuar në vazhdimësi masën absolute të këtij informaliteti. Kështu, e kontestueshme në terma të përgjithshëm vazhdon të jetë marrëdhënia e fermerit kontributpagues me pronësinë mbi tokën, sepse të gjithë e dimë, që kjo e fundit mbart shumë probleme të zbatimit ose jo të ligjit të ndarjes fillestare të tokës, të mosregjistrimit zyrtarisht të një pjese të saj, kthimit fizikisht të një pjese të tokës bujqësore ish-pronarëve, ashtu si ndeshen probleme të mungesës së dokumentacionit zyrtar edhe për format e ndryshme të transakcioneve mbi tokën bujqësore.

**Ku është konstatuar tjetër ky informalitet?**

Informaliteti të shtuar ka prodhuar dhe kriteri tjetër, ai i domosdoshmërisë së shfrytëzimit të tokës për qëllime bujqësore. Këtu mosekzistenca e asnjë kufizimi për sipërfaqen e projektuar të tokës, ka mbështetur ndër vite, karakterin asistencial të skemës, ndoshta me synimin që potencialisht të gjithë të kenë të ardhura në moshën e pensionit. Kështu, edhe pse kërkesa e skemës është që kontributet të





"Nuk është përbushur misioni i skemës së të vetëpunësuarve në bujqësi"

## Eksperti: Ndryshimet në skemën e sigurimit të fermerëve

"Kritere të forta për pronësinë reale të tokës"

Voltiza Duro

**N**umri i personave që sigurohen në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi është më pak se 70 mijë vetë, pra sa 1/6 e atyre që publikon INSTAT-i. Eksperti i sigurimeve shoqërore, Hasan Hoxha tregon për 'Gazeta Shqiptare' se skema, sidomos pas vitit 2015, nuk është në funksion të përbushjes së misionit që ka për shtimin sasior të numrit të kontributuesve. Ai më tej shton se kontributuesit që përfshihen në skemë, nuk sigurohen aq për të shtuar vitet e tyre kontributive në funksion të pensionit të pleqërisë dhe se skema e të vetëpunësuarve në bujqësi, është e kushtueshme. Hoxha thekson se duhen bërë ndryshime me kritere të plota e të qarta, që sjellin pronësinë reale të tokës; apo për kushte rigorozë për kohën dhe mënyrën e pagesës së kontributeve.

**Veç anës legislative dhe zbatimit të kritereve, a ka të tjera probleme, skema aktuale e të vetëpunësuarve në bujqësi?**

Po, problemet e mësipërme nuk janë të vetmet. Aktualisht, skema ka dhe probleme të përbajtjes apo dhe të funksionimit të brendshëm të saj. Nëse reforma e vitit 2014 e kryer në fushën e pensioneve, sipas logjikës ekonomike dhe sociale, shkon në favor të vlerësimit më të mirë të kontributeve, të plotësimit më shumë të interesave të qytetarëve, shkon në përbushjen më mirë të misionit të skemës publike aktuale të pensioneve, njëherazi, edhe të misionit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore: duhet pohuar se këto kërkesa nuk kanë gjetur shprehjen e tyre në pjesën e skemës të të vetëpunësuarve në bujqësi. Sidomos vitet e fundit, treguesit kryesorë të kësaj pjesë të skemës, janë zhvilluar në të kundërtën e asaj që pohuam më sipër.

**Sa është numri i personave të siguruar dhe sa e përbush misionin e saj kjo skemë?**

Skema tani, sidomos pas vitit 2015, nuk është aq në funksion të përbushjes së misionit që ka, në kuadrin e misionit të përgjithshëm të ISSH-së, për shtimin sasior të numrit të kontributuesve. Aktualisht, numri i atyre që



sigurohen në skemë, është më pak se 70 mijë vetë, është sa 1/6 e atyre që INSTAT-i llogarit në marrëdhënie pune në bujqësi. Aq më tepër; pas vitit 2015, numri i kontributuesve, në tërësi dhe sipas disa grupmoshave, ka ardhur në rënie. Struktura e kontributuesve në bujqësi ka pësuar ndryshime të theksuara, aq sa mund të themi se ajo është e deformuar, sa i përket qëllimit kryesor të qenies së saj. Kontributuesit që përfshihen në skemë, siç tregojnë të dhënat, nuk sigurohen aq për të shtuar vitet e tyre kontributive në funksion të pensionit të pleqërisë. Për të synuar shtimin e viteve më shumë se 35, për kategorinë që ato i ka plotësuar para reformimit të skemës, apo për të shtuar vitet më shumë se 15, për ata që këtë minimum ligjor e kanë plotësuar, për të qenë përfuturës në pensionit të pleqërisë.

**Cilat janë përgjithësisht qëllimet e pagesës së kontributeve të fshatit nga vetë individët?**

Të dhënat zyrtare, në dy vitet e fundit, tregojnë se kontributuesit e fshatit më shumë paguajnë për të "kapur" disa kushte që atyre u sjellin përfitime me kosto të ulët dhe pothuajse të menjëhershme. Për shembull, për të realizuar minimalisht 15 vite kontributive, që është dhe kushti ligjor për të qenë pjesë e skemës së pensioneve; për të plotësuar 30 vite kontributive, siç është rasti i minatorëve, kur ata i kanë plotësuar dy kushtet e tjera; për të plotësuar 30

vite kontributive grupi i I nënave me shumë fëmijë që ata të marrin të drejtën e pagesës për lejen e lindjes; për të plotësuar kushtin ligjor të përfitimit nga KMCAP-i, që kërkon të paktën, një vit pune ose një vit kontribute në pesë vitet e fundit; për të realizuar kushtin e viteve kontributive që kërkohen për të përfutur pension të reduktuar, si dhe për të tjera benefite.

**Sa e kushtueshme është skema e të vetëpunësuarve në bujqësi?**

Skema e të vetëpunësuarve në bujqësi, për shkak të organizimit të saj, është e kushtueshme, shpenzimet administrative për të, krahasuar me pjesën tjetër të skemës, janë gati dy herë më të larta. Nëse shpenzimet administrative vjetore për krejt skemën e sigurimeve shoqërore janë nën kufirin 2 përqind të tërësisë së shpenzimeve, shpenzimet administrative për pjesën e skemës së të vetëpunësuarve në bujqësi, të rrillogaritura, presupozohen të jenë rreth 4 herë më të larta. Në strukturë, shumicën dërrmuese të këtyre shpenzimeve e zënë pagat, për shkak të numrit të lartë të inspektorëve që mbulojnë këtë fushë. Më e arsyeshme do të ishte që struktura e inspektorëve të bujqit të riorganizohet, të ishte pjesë e strukturës funksionale të sigurimeve shoqërore, duke e përshtatur me organizimin e sotëm të pushtetit lokal. Për arsyt që nënvizuar më sipër; por dhe të tjera, skema aktuale për të vetëpunësuarit në bujqësi, duket e tejkalu-

ar në kohë, paraqitet e konsumuar madje, dhe jashtë disa parametrevë ligjore.

**Cilat janë disa prej ndryshimeve që do të bëhen në këtë skemë?**

Prej kohësh mendoj unë, është ndjerë nevoja për ndryshime ligjore të saj; për tu njësuar ajo me skemën vullnetare të sigurimeve, apo që kjo skemë të bëhet e detyrueshme, me kritere të plota e të qarta, me të gjitha variantet, ligjore dhe institucionale, që sjellin pronësinë reale të tokës; sikurse e njëjta gjë për shfrytëzimin e tokës për qëllime bujqësore si dhe për dokumentin ligjor që e vërteton këtë; apo për kritere rigorozë për kohën dhe mënyrën e pagesës së kontributeve. Sigurisht që e vlerësoj dhe variantin tjetër që është në proces miratimi, për ta mbajtur skemën kështu siç ajo është, por me kontribute nën pagën minimale ose ndryshe, me kontribute të reduktuara. Veçse, duhet të themi se edhe përfitimet, gjithashtu, do të jenë të reduktuara. Kësajsoj, për nga niveli i tyre, pensionet për fermerët në të ardhmen e tyre do të ishin përsëri të kategorizuara në dy grupe: pensione urbane dhe pensione rurale. Me këto dy cilësime, kështu duhen ndërtaur, sipas meje, statistikave, profili i evidencave dhe i analizave periodike.

**Sipas jush, cila është pika ku duhet të mësohet më shumë për përmirësimin e skemës së të vetëpunësuarve në bujqësi?**

Nisur nga këndvështrimet të tilla, ajo që patjetër duhet konsideruar, është fakti që të fiksohen mirë nivelet e ardhshme të përfitimeve dhe në përputhje me to, edhe niveli i kontributeve, me qëllim që edhe për të vetëpunësuarit në bujqësi, qasja ekonomike të jetë më e madhe sa i përket raporteve të pensionit me kontribute dhe niveli të pensionit social, pasi ky i fundit, tani për tani, është i barabartë me pensionin minimal të të vetëpunësuarit që sigurohet me 15 vite kontribute. Siç rezultoi edhe nga të dhënat e një ankete, niveli i pensionit social ashtu sikurse dhe masa e pensionit minimal të pleqërisë, mënyra si ato sot përfitohen apo llogariten, vitet e fundit, ka qenë një arsye frenuese për pagesën e kontributeve nga ana e të vetëpunësuarve në bujqësi.

← paguhen atëherë kur punohet toka, një pjesë jo e vogël e fondit kontributiv, është paguar pa e shfrytëzuar tokën për qëllime bujqësore, siç janë disa nga familjet e emigrantëve, toka e të cilëve ka vite që ndihet e braktisur; ashtu siç është pjesa dërrmuese e të migruarve brenda vendit, sidomos të atyre përreth disa qyteteve kryesore, në të cilat sipërfaqja e tokës është vetëm 500 m apo më pak se kaq, cka tregon se edhe ky kriter i vendosur për të shfrytëzuar tokën e, pastaj për t'u njohur si kontributues, në shumë raste është kthyer në një fushë formale, të kapërcyer me vërtetime jo të rregullta nga një pjesë e njësive të qeverisjes vendore.

**Çfarë ndodh nëse kontributet nga kjo kategori nuk paguhen në kohë?**

Ndodh që në një dosje përfitim, të ketë dy lloj vërtetimesh, në varësi të qëllimit: vërtetim që ushtron veprimtari bujqësorë kur i është dashur të jetë kontributues por, dhe vërtetimin e kundërt pra, që nuk shfrytëzohet toka bujqësore, për t'i hapur kështu rrugën pagesës së pensionit për nënat me shumë fëmijë, pensionit familjar; pensionit të parakohshëm për shumë ish-ushtarake, si dhe për të hequr gjendjen debitorë të disa dhjetëra ish-ushtarakeve të tjerë.

Mospagesa në kohën e duhur të kontributeve, si-

pas përcaktimeve ligjore, është shoqëruar me kushtin tjetër ligjor, atë të pagesës së kamat vonesave. Mirëpo, sipas vëzhgimeve të bëra, vjelja e kamatvonesave nuk ka qenë e rregullt, ndërsa shumica e tyre përfaqëson një masë të vogël, kundrejt asaj që kërkohet me ligj. Mjafton të themi se nëse një i vetëpunësuar do të blinte jashtë afatit ligjor njëherazi 10 apo 20 vite kontributive, shumica e kamatvonesave do të ishte sa rreth 50 përqind e shumës së principialit. Nëse do të shihesh kështu të gjithë kontributet e paguara, jo në kohën e duhur, shumica e kamatvonesave do të ishte e konsiderueshme. Veçse, kur kjo kërkesë krahasohet me evidencat sipas disa drejtorive rajonale apo agjencive, dallohen qartë deficitet e krijuara në këtë fushë. Aq më tepër, falja nga qeveria, herë pas here e kamatvonesave pastaj, rivendosja e tyre, kanë ulur seriozitetin e fushës, kanë shtuar nivelin e informalitetit, sidomos nga disa inspektorë të bujqit. Në anën tjetër, për zbatimin e kritereve ligjore në vjeljen e kamatvonesave, nuk ka pasur ndjekje të programuar, nuk ka analiza periodike të plota, as penalitete të aplikuara. Ndërkaq, kanë munguar edhe kontrollat, asnjëherë pagesa e kamatvonesave nuk është audituar, me programe të plota, ndërsa mospagesa e tyre nuk është bërë asnjëherë pengesë për degën e pensioneve, për ti caktuar përfitimet pa asnjë lloj kufizimi.

Lista e plotë/ Ja kur duhet të paraqiteni pranë Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë

Voltiza Duro

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka zbardhur emrat e personave që do t'i nënshtrohen kontrolleve mjekësore në KMCAE Epror gjatë muajit dhjetor për të marrë pensionin. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot listën e plotë me emrat e 253 personave që duhet të kryejnë ekzaminimet brenda muajit pranë Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë. Këta individë, në rastin që nuk do t'i nënshtrohen kontrollit mjekësor; nuk do të mund të marrin apo rimarrin pensionin e invaliditetit nga ISSH. Të gjithë ata persona që bëhen të paafte për çdo veprimtari ekonomike dhe kanë dëmtime fizike apo gjyftime të forta, duke përfshirë verbimin, iu lind e drejta për pension invaliditeti. Për të përfituar këtë lloj pensioni të plotë, të reduktuar

# Kempi, zbardhen emrat e 253 personave që do të kryejnë kontrollet mjekësore

*ISSH: Nëse nuk kryeni ekzaminimin, nuk mund të përfitoni pension*



dhe të pjesshëm, përfituesi ose i autorizuari me prokurë paraqitet në ALSSH të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfitimt të pensionit të invaliditetit. Përfituesi për pension invaliditeti ose i autorizuari me prokurë, së bashku me kërkesën duhet të paraqesë dhe dokumentet që vërtetojnë moshën e identi-

tetin, ato që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës si dhe dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara e gjendjen shëndetësore. Ky dokumentacion i dorëzohet mjekut të ekspertizës, i cili pas verifikimit njofton datën për të kaluar në KMCAE, ose i kthen mbrapsht dokumentet për pasaktësi. KMCAE në mblehjen e tij shqyrton

paraprakisht dokumentet, njofton dhe ekzaminon të sëmurin, merr vendimin përkatës jo në prani të tij, dhe kryetari i KMCAE-it ia komunikon zyrtarisht të sëmurit gojarisht dhe nëpërmjet vërtetimit tip. Kundër këtij vendimi i sëmuri ose invalidi mund të anketohet tek KMCAE-i epror. Ankesa bëhet me shkrim dhe dorëzohet në DRSSH përkatëse.

## EMRAT E PERSONAVE QË DO TË KRYEJNË KONTROLLET MJEKËSORE

LISTA E PERSONAVE QË DO TË PARAQITEN NË KMCAE EPROR PËR MUAJIN DHJETOR 2018						
Nr.	Emër	Mbiemër	KMCAE	Data	Ora	Rrethi
<b>NEUROLOGJI</b>						
1	BEJUSHE	ÇAÇO	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	GJIROKASTER
2	NAIM	HYSA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	DIBER
3	KUJTIM	LLORJA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	DIBER
4	MARASH	DEDAJ	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	SHKODER
5	GJON	DODANI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	SHKODER
6	ZEF	MAKLAJ	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	SHKODER
7	VITORE	DELAJ	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	SHKODER
8	BUJAR	SHAQIRI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	SHKODER
9	AVNI	HOXHA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	SHKODER
10	MARTE	MARKU	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	SHKODER
11	ADEM	HOTAJ	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	SHKODER
12	VASIL	LEMO	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	KORCE
13	VILSON	MEKA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	KORCE
14	FERDINANT	MUSTAFA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	KORCE
15	FATBARDHA	GJONI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	VLORE
16	VALENTINA	JAZAJ	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	VLORE
17	LEONIDHA	LIÇAJ	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	VLORE
18	PERPARIM	MUCOGLAVA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	BERAT
19	THANAS	HARIZAJ	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	BERAT
20	DUDI	BAJRAM	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	FIER
21	ENVER	GEGA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	FIER
22	SERVET	SULLOLLARI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	FIER
23	MUHARREM	ASIMETAJ	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	FIER
24	KASTRIOT	PERGJERGJI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	LEZHE
25	ARDIANA	LLESHI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	LEZHE
26	FLORINTA	SHTJEFNI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	LEZHE
27	ÇUP	SCANA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	LEZHE
28	MARJANA	MARKU	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	LEZHE
29	VITORE	KAZA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	LEZHE
30	MENTOR	CAKA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	ELBASAN
31	SHKELQIM	BAÇELLARI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	ELBASAN
32	BAJRAM	BUJKU	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	ELBASAN
33	EDMOND	NIKOLI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	TIRANE
34	KADRIJE	BICERRI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	TIRANE
35	PASHA	MAÇI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	TIRANE
36	IRENA	SULKU	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	TIRANE
37	HASAN	BRUSHA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	TIRANE
38	PETRIT	SHIMA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	TIRANE

39	FATMIRA	BARDHI	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	TIRANE
40	GJON	GJONAJ	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	TIRANE
41	SOFIKA	FERJA	NEUROLOGJI	11.12.2018	08,00	TIRANE
<b>PATHOLOGJI</b>						
42	INATASHA	NAÇI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	SARANDE
43	MIHAL	BINJAKU	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	GJIROKASTER
44	KUMRIJE	CEVANI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	DIBER
45	ENTELE	SULA	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	DIBER
46	MARJETA	MATA	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	DIBER
47	KUJTIM	MERO	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	KORCE
48	AVNI	KAMBER	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	KORCE
49	LEFTERIJE	VEIZI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	KORCE
50	VIKTOR	BEQIRAJ	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	KORCE
51	RAZIJE	XHELO	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	KORCE
52	FITIM	BYLYKU	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	KORCE
53	MIRJETA	SINANI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	KORCE
54	LODOVIK	DEDA.	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	SHKODER
55	GEZIM	MEHAJ	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	SHKODER
56	ARIOLA	CENI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	SHKODER
57	BENARDIN	PREÇI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	SHKODER
58	ARBANA	HYSAJ	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	SHKODER
59	ZEF	SHKOZA	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	SHKODER
60	DAVA	NDUJ	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	LEZHE
61	ALFRED	KOLA	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	FIER
62	AISHE	TOPI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	ELBASAN
63	FATMIR.	CANI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	ELBASAN
64	SANE	SINANI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	ELBASAN
65	MARIE	GJERA	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	DURRES
66	MURAT	KORRIKU	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	KAVAJE
67	SABRI	ÇELA	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	KAVAJE
68	MELI	BANO	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
69	OSMAN	SELI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
70	ERMAL	MICA	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
71	ANDREA	SHARKO	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
72	LEILA	LAMI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
73	GJOKE	UKCAMAJ	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
74	ABRAHIM	MARKU	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
75	VASILIKA	LAMI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
76	ERMIRA	HOXHA	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
77	MAKSUT	MATMUJA	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
78	ASLLAN	BREGU	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
79	SEMIHA	KULLAFI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
80	SKENDER	MYSLYMI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
81	ADRIAN	SKENDRI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
82	FATRI	MAXHAKU	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
83	LJUE	PALUSHI	PATHOLOGJI	12.12.2018	08,00	TIRANE
<b>ORTOPEDI</b>						
84	GJYLSO	KURDETA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	SARANDE
85	FIQRET	KAMBERI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	KUKES
86	BAHRIJE	GJUNI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	KUKES
87	HEKURAN	ALLA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	DIBER
88	HAMZA	SHIRA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	DIBER
89	PASHKE	BUSHI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	DIBER
90	BEKTASH	DOSTI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	GJIROKASTER
91	ELIVERTA	GALO	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	KORCE
92	PANDELI	JORGO	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	KORCE
93	ADELINA	ASABELLA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	KORCE
94	ALUSH	PALLA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	KORCE
95	ELIVERTA	KAPE	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	KORCE
96	ARDIAN.	TRAKO	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	KORCE
97	IRFAN	ÇELA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	KORCE
98	ROBERT	RROKU	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	SHKODER
99	RASIM	MUKAJ	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	SHKODER
100	ZOJE	NIKAJ	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	SHKODER



101	AFERDITA	MERDANI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	BERAT
102	LULEZIME	DOLLANI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	BERAT
103	NAIM	KUÇUKU	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	BERAT
104	SKENDER	HOXHA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	BERAT
105	PELLUMBESHA	HOXHA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	BERAT
106	RAJSA	SAULI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	FIER
107	REMZIE	DOKO	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	FIER
108	ARQILE	JANKA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	FIER
109	LUFTAR	HOXHA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	FIER
110	NATASHA	BUZI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	FIER
111	PASHK.	NDRECA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	LEZHE
112	ZOJË	MARKU	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	LEZHE
113	VERA	LEKAJ	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	LEZHE
114	SANDER	NDREU	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	LEZHE
115	LUIGJ	KELMENDI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	LEZHE
116	ISMET	TOÇILLA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	ELBASAN
117	RUZHDIJE	SENA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	ELBASAN
118	SHERIF	DACI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	DURRES
119	ARDJAN	MURATAJ	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	TIRANE
120	LILIANA	TAFANI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	TIRANE
121	MYFTIHANE	KALENJA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	TIRANE
122	RESMIJE	SHOTI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	TIRANE
123	XHEMILE	FUÇIA	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	TIRANE
124	ZINIT	FERKO	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	TIRANE
125	MUSTAFA	ZEQIRI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	TIRANE
126	ASTRIT	MEMAJDINI	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	TIRANE
127	PASHAME	LITO	ORTOPEDI	14.12.2018	08,00	TIRANE
<b>PSIKIAT/OCULIST</b>						
128	SHANO	THANASI	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	GJIRKASTER
129	ASTRIT	KRYPI	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	DIBER
130	SEIT	KOXHA	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	DIBER
131	FLAMUR	LIKA	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	DIBER
132	ARTAN	KURTI	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	DIBER
133	ENGJELUSHE	ÇELIKU	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	KORCE
134	ILIR	TEMALI	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	SHKODER
135	AGE	KUQAJ	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	SHKODER
136	AGIM	FERATAJ	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	FIER
137	AGRON	LIÇI	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	ELBASAN
138	ZYBER	TARKO	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	ELBASAN
139	PEME	LISI	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	ELBASAN
140	ARTUR	KURA	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	TIRANE
141	ARBEN	OSMANAJ	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	TIRANE
142	AHMEDJE	BABQORRI	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	TIRANE
143	SKENDER	GJANA	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	TIRANE
144	IRIS	HITOCANAJ	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	TIRANE
145	ZAIDE	REXHMATI	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	TIRANE
146	ILMIE	NELA	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	TIRANE
147	LIRJAN	HYSENLLARI	PSIKIAT/OCULIST	18.12.2018	08,00	TIRANE
<b>KARDIOLOGJI</b>						
148	LIZË	PALOKA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SARANDE
149	FOTO	ÇILJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SARANDE
150	BAJRAM	SHUAIPI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SARANDE
151	ROBERT	XHALIA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	GJIRKASTER
152	IRAKLI	MASTORA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	GJIRKASTER
153	VIKTOR	KUKA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	GJIRKASTER
154	HEKURAN	BEOLLARI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	GJIRKASTER
155	SHPRESA	DURALLIU	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	GJIRKASTER
156	FLORA	PORJA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	DIBER
157	BARJAM	MEKOLLI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KORCE
158	PIRO	CINI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KORCE
159	HAXHI	HYKA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KORCE
160	ANDON	ANDONI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KORCE
161	ISLAM	PURBA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KORCE
162	ADRIAN	EMINI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KORCE
163	VISAR	DEMELLI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KORCE
164	RAFIZAN	ETHEM	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KORCE
165	ROBERT	QIROLLARI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KORCE
166	BASHKIM	MANE	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KORCE
167	FIQIRETE	BLACËRI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KORCE
168	HAJRI	FASLIJA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SHKODER
169	FIDAJET	NASUFI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SHKODER
170	TAHSIM	REÇI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SHKODER
171	LAZER	KRYPCA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SHKODER
172	LAZER	FUSHAZI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SHKODER
173	SHYQYRI	HYSAJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SHKODER
174	ISMET	HALLUNAJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SHKODER
175	NIKE	BUJAJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SHKODER
176	NDUE	MARKU	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SHKODER
177	LINE	SHAHINAJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SHKODER
178	SYME	HARAPEJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	SHKODER
179	MARK	HILA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	LEZHE
180	VELI	BRAHJA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	LEZHE
181	DED	ALIA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	LEZHE
182	LAZER	ARAPI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	LEZHE
183	NDUE	GJONPALAJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	LEZHE
184	BARDHOK	PERLIKA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	LEZHE
185	BARDHOSH	SHERIFI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	VLORE
186	SOKRAT	MERSINI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	VLORE
187	ANTONETA	MEZINI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	VLORE
188	GJERGJI	MULLISI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	BERAT
189	TAJAR	MAHMUTAJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	BERAT
190	AGIM	KANAÇI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	BERAT
191	NDERIM	DELIU	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	BERAT
192	MYZAFERE	RUÇI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	BERAT
193	MAKSIM	ÇUNI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	FIER
194	PELLUMB.	IMERALILAJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	FIER
195	FLAMUR	SERJANAJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	FIER
196	PETRIT	GODUNI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	FIER
197	LLESH	MARKU	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	FIER
198	VIKTOR	GJATA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	ELBASAN
199	ZHANETA	DERVISHI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	ELBASAN
200	AGRON	LUFTA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	ELBASAN
201	KUJTIM	BAKIU	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	ELBASAN
202	ALBERT	MURATI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	ELBASAN
203	RIDVANA	GJEÇI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	KAVAJE
204	PETRIT	NEZAJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
205	FERDINANT	RROGA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
206	DASHAMIR	SADIKU	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
207	ASTRIT	ILJAZAJ	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
208	FATMIR	SHEMISHIRI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
209	BEDRI	ALVORA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
210	BAJRAM	QYLAFI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
211	AGIM	HASANI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
212	SULEJMAN	LLAVESHI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
213	THEODHOR	MERO	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
214	PETRIT	ZENELI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
215	VEIZ	MOLLA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
216	DHIMITER	LLAZARI	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
217	DASHAMIR	KOSOVA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
218	BUJAR	ZANA	KARDIOLOGJI	19.12.2018	08,00	TIRANE
<b>KIRURGI</b>						
219	LULEZIME	DELILAJ	KIRURGI	21.12.2018	08,00	GJIRKASTER
220	JORGJI	GOÇI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	GJIRKASTER
221	LEK	KACOLI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	SHKODER
222	VIKTOR	JAUPI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	KORCE
223	BEHAR	MALIQI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	KORCE
224	SELAM	HOXHALLARI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	KORCE
225	AVNI	HYKO	KIRURGI	21.12.2018	08,00	KORCE
226	AIDA	LILE	KIRURGI	21.12.2018	08,00	KORCE
227	ANDREA	MEHMETLLARI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	KORCE
228	ROZETA	BREGU	KIRURGI	21.12.2018	08,00	KORCE
229	AKSINJE	MEÇE	KIRURGI	21.12.2018	08,00	KORCE
230	FERJAT	METAJ	KIRURGI	21.12.2018	08,00	VLORE
231	MADE	HOXHA	KIRURGI	21.12.2018	08,00	BERAT
232	BURBUQE	BEHARI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	BERAT
233	FIQIRETE	BREGU	KIRURGI	21.12.2018	08,00	FIER
234	XHEVAIR	MEONIÇI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	FIER
235	LLAMBI	PRIFTI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	FIER
236	GYSHO	ABAZAJ	KIRURGI	21.12.2018	08,00	FIER
237	FLORA	DEDA	KIRURGI	21.12.2018	08,00	LEZHE
238	OLLGA	KREKAS	KIRURGI	21.12.2018	08,00	ELBASAN
239	ARTA	HODO	KIRURGI	21.12.2018	08,00	ELBASAN
240	NASIRIE	TARKO	KIRURGI	21.12.2018	08,00	ELBASAN
241	ENGJELUSHE	KRYEMADHI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	ELBASAN
242	SHKELQIM	BRAÇJA	KIRURGI	21.12.2018	08,00	ELBASAN
243	FITNETE	PUPRIQI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	DURRES
244	GANI	DIBRA	KIRURGI	21.12.2018	08,00	TIRANE
245	PALI	NIKBIJAJ	KIRURGI	21.12.2018	08,00	TIRANE
246	LUMTURIE	DEMA	KIRURGI	21.12.2018	08,00	TIRANE
247	FATMIR	VELIU	KIRURGI	21.12.2018	08,00	TIRANE
248	VLADIMIR	LAZAJ	KIRURGI	21.12.2018	08,00	TIRANE
249	ALMA	ÇORATI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	TIRANE
250	NADIRE	HIDA	KIRURGI	21.12.2018	08,00	TIRANE
251	ILIRJAN	DAKO	KIRURGI	21.12.2018	08,00	TIRANE
252	DALLANDYSHE	HASANI	KIRURGI	21.12.2018	08,00	TIRANE
253	BINAK	KAMENA	KIRURGI	21.12.2018	08,00	TIRANE

Problemet familjare, 40 vjeçari del jashtë kontrollit

# Tenton të djegë dy fëmijët e veten, neutralizohet vlonjati

## Vjehrra: Zigur Veshi është i alkoolizuar

Një 40-vjeçar në Vlorë ka tentuar të djegë dy fëmijët e tij duke i spërkatur me benzinë. Fatmirësisht ka ndërhyrë policia duke arritur t'i shpëtojë në kohë. Gjithçka ka ndodhur kur Zigur Veshi është nisur nga shtëpia me fëmijët e mitur 3 dhe 4 vjeç duke njoftuar të vëllanë se do vriste fëmijët dhe veten.



Menjëherë vëllai i tmeruar ka njoftuar policinë. 40-vjeçari ka shkuar poshtë shtëpisë së vjehrrit ku gjendej dhe bashkëshortja e tij, e cila ishte larguar nga banesa një ditë më parë. Pasi ka folur në emër bashkëshortes kjo e fundit ka dalë në ballkon. Ai ka nxjerr një bidon me benzinë 1.5 litra dhe është spërkatur me të dy fëmijët. Policia, e cila ishte njoftuar më parë i ka bërë thirrje mos

të kryente veprimin e gabuar, pasi po rrezikonte fëmijët. Ai nuk e ka dëgjuar thirrjen dhe ka nxjerrë çakmakun. Sapo ka tentuar ta

ndeze është neutralizuar menjëherë prej policisë. Babai është transportuar për në polici së bashku me fëmijët. Në vendin e ngjarjes ka

mbërritur dhe mamaja e 40-vjeçarit, e cila ka kërkuar të marrë fëmijët ndërkohë që vjehrra e tij dëshmon se ai është i alkoolizuar.



Polici grek i Igumenicës mbrohet nga avokatë shqiptarë

## Shoqëronte i armatosur deputetin grek, gjykata vendos masën

Gjykata e Sarandës dha të dielën masën e sigurisë 'Detyrim Paraqitje' për policin grek, Marios Gogolos, i cili u arrestua gjatë ditës së shtunë në Sarandë. Ai po udhëtonte drejt Bularatit, ndërsa pas kontrolleve atij iu gjet një armë, të cilën e kishte pa leje. Gjykata dhe masën e sigurisë detyrim paraqitje dy herë në muaj për policin. Polici i arrestuar ka deklaruar se nuk ishte në dijeni se nuk lejohej arma e shërbimit, ndërsa ai u mbrojt nga avokatë shqiptarë. Seanca gjyqësore u zhvillua me dyer të mbyllura. Polici grek Marios Gogolos është arrestuar nga policia e Sarandës me armë zjarri teksa shoqëronte deputetin e shtetit fqinj, Vasili Jojaka, drejt fshatit Bularat. Policia njoftoi se shtetasi me iniciale M.G, 35 vjeç, me detyrë punonjës policie në Igumenicë, u arrestua rreth



### NGJARJA

Polici grek Marios Gogolos është arrestuar nga policia e Sarandës me armë zjarri teksa shoqëronte deputetin e shtetit fqinj, Vasili Jojaka, drejt fshatit Bularat.

orës 09.45, në aksin rrugor "Sarandë-Gjirokastrë", në vendin e quajtur "Ura e Kranesë", ndërsa ai ishte duke udhëtuar në drejtim të fshatit Bularat, Gjirokastrë. 35-vjeçari është kapur në flagrancë nga shërbimet e policisë me një armë zjarri pa leje, e tipit "pistoletë" me 6 fishekë.



## REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA KUSHTETUESE KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

### SHPLLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit":

1. Rishpall 2 (dy) vende vakante për "Specialist IT" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

### KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË PARË PËR "SPECIALIST IT":

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- b. Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- c. Të ketë eksperiencë në menaxhimin e projekteve TIK.
- d. Të ketë eksperiencë në hartimin e politikave të brendshme IT dhe planifikime ne fushen IT.
- e. Të ketë njohuri shumë të mira për infrastrukturën e IT dhe sistemet të cilat implementohen mbi to.
- f. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

### KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË DYTË PËR "SPECIALIST IT":

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- b. Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- c. Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- d. Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- e. Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- f. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

2. Shpall 1 (një) vend vakant për "Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.

### KËRKESA TË POSAÇME TË POZICIONIT "PËRKTHYES":

1. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip;
2. Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
3. Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

### KUSHTE TË PËRGJITHSHME PËR VENDET VAKANTE "SPECIALIST IT" DHE "PËRKTHYES"

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 dhjetor deri më 12 dhjetor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 12 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 dhjetor deri më 12 dhjetor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.




## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:  
Përdorni rigonin  
e bardhë për  
trajtimin e mykut

## KESHILLA



7 gabimet që  
ndikojnë në  
shtimin e  
kilogramëve

# Sabian Memishaj:



◆ Kardiokirurgu:  
Ja cilat janë  
simptomat  
kryesore të  
sëmundjes që  
çon në vdekje

## Si të trajtoni zgjerimin e enës kryesore të gjakut

"Kujdes nga duhani e tensioni  
i lartë, përbëjnë rrezik"

• Efektet antioksiduese të çajit të sherbelës. Ushqimet që duhet të konsumoni për veshka të shëndetshme

Kardiokirurgu: Ja cilat janë simptomat kryesore të sëmundjes që çon në vdekje

# Sabian Memishaj:

## Si të trajtoni zgjerimin e enës kryesore të gjakut

"Kujdes nga duhani e tensioni i lartë, përbëjnë rrezik"

Voltiza Duro

**D**uhanpirja dhe keqshpyerja janë disa prej faktorëve të rrezikshëm që mund të shkaktojnë një sërë sëmundjesh në organizmin e njeriut. Me kalimin e moshës, mund të shfaqet zgjerimi i pjesës së poshtme të enës kryesore të gjakut që e shpërndan atë në të gjithë trupin. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare" kardiokirurgu Sabian Memishaj tregon të gjithë shkaqet e sëmundjes që njihet si aneurizëm abdominal dhe pasojat që mund të jenë edhe fatale për jetën. Mjeku më tej sqaron mënyrat e diagnostikimit dhe trajtimin e sëmundjes për të gjithë pacientët e prekur nga sëmundja.

### Cfarë është aneurizma e aortës abdominale?

Një aneurizëm abdominal është zgjerimi i pjesës së poshtme të aortës, e cila është ena kryesore e gjakut që e shpërndan atë në të gjithë organizmin. Meqenëse aorta është furnizuesi kryesor i organizmit me gjak, çarja e saj mund të çojë në vdekje të menjëhershme. Mbi bazën e madhësisë së aortës, si dhe mbi bazën e shpejtësisë së rritjes së saj, trajtimi mund të jetë vetëm ndjekje me skaner apo dhe ndërhyrje e menjëhershme kirurgjikale.

### Mund të përmendni disa prej shkaqeve kryesore të sëmundjes?

Të qenit maskull dhe përdorues i duhanit rrit rrezikun për aneurizëm të aortës abdominale. Gjithashtu, ata per-

sona që kanë histori familjare për këtë sëmundje duhet të kryejnë EKO të barkut rreth moshës 60 vjeç. Femrat, të cilat nuk kanë shenja, nuk kanë pirë kurrë duhan dhe nuk kanë histori familjare nuk kanë nevojë të kontrollohen. Duhani rrit rrezikun për aneurizëm të aortës. Duhani dëmton aortën dhe dobëson muret e saj. Arterioskleroza ndodh kur dhjami apo substancat e tjera depozitohen në muret e enëve të gjakut. Kjo situatë mund të rritë rrezikun për zgjerim të aortës. Tensioni i lartë mund të rritë rrezikun për aneurizëm të aortës abdominale pasi ai mund të dëmtojë dhe dobësojë muret e aortës. Aneurizma e aortës mund të shkaktohet nga sëmundje që prekin enët e gjakut dhe që krijojnë inflamacion tek to.

Infeksionet siç janë ata bakteriale ose fungale (myk), mund të shkaktojnë aneurizëm të aortës abdominale, po ashtu sëmundja shkaktohet edhe nga traumat siç janë aksidentet me makinë apo trashëgimia në familje. Aneurizmat mund të krijohen kudo përgjatë aortës. Kur formohen në pjesën e sipërme të aortës, në kraharor ato quhen aneurizma (zgjerim) të aortës torakale. Kur aneurizmat formohen në pjesën e poshtme të aortës, quhen aneurizma të aortës abdominale.


### Cilat janë simptomat e para të aneurizmës së aortës?

Aneurizma e aortës abdominale zakonisht zmadhohet gradualisht dhe pa ankesa dhe kështu është e vështirë të zbulohet. Disa zmadhohen gradualisht ndërsa disa të tjera me shpejtësi. Është e vështirë të parashikohet shpejtësia e zmadhimit të aortës. Kur aneurizma rritet disa njerëz vënë re një ndjesi pulsimi në bark; dhimbje të vazh-

dueshme në shpinë ose anash barkut.

### Cilat janë komplikacionet kryesore të sëmundjes?

Çarja e një ose më shumë shtresave të murit të aortës (diseksion i aortës) ose raptura (çarja e plotë e murit të aortës) e aneurizmës së aortës janë komplikacionet kryesore të kësaj sëmundjeje. Çarja e aneurizmës së aortës mund të çojë në një gjakrrjedhje të brendshme dhe në një vdekje të papritur. Sa më e madhe të jetë aneurizma aq më shpejt rritet ajo dhe aq më i madh është rreziku i çarjes së saj. Një tjetër komplikacion i aneurizmës është rreziku i formimit të kaogulave (mpiksjeve) të gjakut. Mpiksje të vogla të gjakut formohen në hapësirën e brendshme të formuar nga aneurizma e aortës. Nëse një



copë e mpiksurs shkëputet nga muri i brendshëm i aneurizmës, ajo mund të futet në gjak dhe të bllokojë arterie të tjera në këmbë në veshka apo në organet e barkut. Kjo mund të shkaktojë infarkt në këto organe me pasojë fatale për jetën.

### Po simptomat e çarjes së aortës abdominale cilat janë?

Çarja e aortës abdominale jep dhimbje të forta dhe të menjëhershme të shpinës ose të barkut si një goditje me thikë; dhimbje që përhap-



Kardiokirurgu Sabian Memishaj

en tek këmbët apo në shpinë; djersje; ndjesinë e të ftohtit; marrje mendsh; të vjella; tensioni i ulët; puls i shpejtë.

### Si bëhet diagnostikimi i sëmundjes?

Aneurizma e aortës abdominale zakonisht zbulohet gjatë ekzaminimeve për arsye të tjera. Për të diagnostikuar aneurizmen e aortës abdominale mjeku do ju pyesë për

saktësisht përmasën dhe vendndodhjen e saj.

### Cilat janë mënyrat e trajtimit të aneurizmës së aortës abdominale?

Qëllimi i trajtimit është që aneurizma mos të arrijë deri në çarje të aortës. Opsionet janë ose monitorim mjekësor ose kirurgji. Vendimi merret në bazë të përmasës së aneurizmës së aortës dhe se me çfarë shpejtësie po rritet. Nëse aneurizma e aortës abdominale është e vogël dhe nuk shfaqen simptoma, mjeku rekomandon monitorim mjekësor që do të thotë vizita të rregullta tek mjeku për tu siguruar që aneurizma nuk po zmadhohet dhe menaxhim të sëmundjeve të tjera të cilat mund të ndikojnë në zmadhimin e aneurizmës së aortës abdominale. Me shumë mundësi mjeku rekomandon teste të vazhdueshme (MRI, EKO, CT) për të kontrolluar përmasat e aneurizmës. Shpeshtësia e kontroleve varet nga përmasat e aneurizmës, nëse ka apo jo zmadhim të aneurizmës dhe se me çfarë shpejtësie po zmadhohet aneurizma. Nëse aneurizma e aortës abdominale është 5cm ose më e madhe, rekomandohet kirurgjia e cila gjithashtu rekomandohet në rastet kur shpejtësia e rritjes së aneurizmës është e madhe. Nëse pacienti ka simptoma të tilla si dhimbje stomaku apo ka një aneurizëm që rrjedh apo dhemb, mjeku rekomandon menjëherë trajtimin kirurgjik. Mundësitë kirurgjikale janë kirurgji e hapur abdominale apo kirurgji endovaskulare.





# 7

## gabimet që ndikojnë në shtimin e kilogramëve



Shtimi në peshë, jo vetëm që na shqetëson, por, gjithashtu, mund të jetë një nga shkaqet kryesore për problemet shëndetësore. Sipas studimeve, mbipeshja rrit rrezikun e vdekjes së parakohshme. Megjithatë, përgjigjia për se përse po shtoni sa më shumë kilogramë mund të gjendet në rutinën tuaj të mbrëmjes. Nëse jeni të vetëdijshëm për arsyet e kilogramëve që po fitoni, gjithkush nga ju mund të merrni masa paraprake dhe të zgjidhni një mënyrë të shëndetshme jetese, për të evituar shëndoshjen dhe problemet shëndetësore. Më poshtë do të listojmë disa nga gabimet që ju po bëni para se të flini dhe arsyet pse ju po shtoni sa më shumë kilogramë, pa e vënë re fare:

### Hani shumë orët e vona të natës.

Të gjithë e dimë për rregullin se nuk duhet ngrënë më ushqim pas orës 6 pasdite, por kjo nuk na ndalon të hamë shumë ushqim në darkë dhe ta shkelim këtë rregull. Studimet na tregojnë se të hahet vonë të çon në shtim në peshë. Përveç kësaj, mund të rrisë nivelin e kolesterolit, nivelet e insulinës dhe të ndikojë negativisht në treguesit tanë hormonalë.

### Pirja e kafes në mbrëmje

Pirja e kafesë vonë në mbrëmje jo vetëm që dëmton gjumin tuaj, por ju shkakton probleme edhe me tensionin. Kafja e fundit që mund të pini duhet të jetë 6 orë para se të flini. Shkencëtarët lidhin konsumimin e acidit klorogjenik, të gjetur në kafe, si nja nga arsyet më të mëdha për shtimin e peshës kur konsumoni kafe natën vonë. Mundohuni të zëvendësoni kafën me çaj bimor.

### Truri juaj ka nevojë për më shumë gjumë

Një sasi e shëndetshme e gjumit është rreth 7-8 orë në natë. Nëse do të flini më pak,

trupi juaj do të shfaqë menjëherë shenjat e problemeve shëndetësore. Studimet kanë vërtetuar se ekziston një lidhje midis fjetjes së pakët dhe ndryshimeve negative në metabolizmin. Një faktor tjetër vendimtar mund të jetë fakti që mungesa e mjaftueshëm e gjumit

çon në lodhje dhe, për rrjedhojë ju do të jeni më të fjetur dhe do të keni një jetë më pak rritëm dhe aktivitet fizik.

### Duhet të shkoni në palestër apo më e pakta, të ecni!

Ushtrimet dhe aktiviteti fizik

luajnë një rol vendimtar në humbjen e peshës, pasi rrisin metabolizmin dhe djegin kaloritë. Është e domosdoshme të praktikoni edhe stërvitjen më të moderuar në baza ditore, kështu që nëse ecni rreth 15 minuta çdo ditë, do të digjini deri në 100 kalori shtesë.

### Përdorimi i pajisjeve elektronike në mbrëmje, shumë i dëmshëm

Studimet konfirmojnë se ju po fitoni në peshë dhe po bëni një gjumë të keq, pasi në mbrëmje po përdorni aparate elektronike që lëshojnë rreze. Këto pajisje ndërhyjnë negativisht në trupin tuaj, i cili shfaq probleme në prodhimin e melatoninës, e cila është një hormon përgjegjës për rregullimin e cikleve të gjumit. Në vend që të navigoni përmes rrjeteve sociale para se të shkoni në shtrat, zgjidhni të lexoni një libër interesant ose të dëgjoni muzikë qetësuese.

### Duhet të zgjoheni më herët!

Besoni apo jo, hulumtuesit thonë se njerëzit që janë të mësuar të zgjohen herët në mëngjes kanë indeks më të ulët të masës trupore, sesa ata që janë të mësuar të ngrihen pas orës 10 të mëngjesit. Është vërtetuar se nëse do të dilni jashtë dhe do të merrni rrezet e para të diellit, ose siç i njohim, ato të mëngjesit ju do të jeni shumë herë më të shëndetshëm se sa ata që zgjohen vonë. Pra, zgjohuni herët, thjesht zgjohuni herët.

### Përdorni gjithmonë ngjyrat e duhura

Ngjyra blu promovon relaksim dhe, prandaj, mund të flini më mirë. Ndërkohë, ngjyra si të kuqe ose portokalli e bëjnë të ndjeheni energjik dhe të uritur.





# Këshilla

## Ushqimet që duhet të konsumoni për veshka të shëndetshme

**S**hëndeti i veshkave është thelbësor për mirëqenien tonë e problemet me veshkat shkaktojnë sëmundje të tjera kardiovaskulare. Për fat të mirë ka disa ushqime që i mbajnë veshkat të shëndetshme, falë antioksidantëve që janë armiq të sëmundjeve kronike. Ndaj është shumë e rëndësishme që të ushqeheni me ushqime të pasura me antioksidantë.

### Specat e kuq

Specat e kuq përmbajnë pak kalium por shumë vitamina si C, B6, A, acid folik dhe fibrë. Janë shumë të mira për shëndetin e veshkave. Gjithashtu përmbajnë likopen, një antioksidant që e mbron organizmin nga radikalet e lira. Specin e kuq mund ta konsumoni bashkë me peshkun ton, mishin e pulës ose në sallata.

### Lakra

Kjo perime është i pasur me fitoushqyes që largojnë radikalet e lira nga organizmi dhe pakësojnë rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare. Lakra përmban vitaminat K dhe C, fibrë, vitaminat B6, dhe acid folik që i mban veshkat të shëndetshme.

### Lulelakra

Kjo perime miqësore me veshkat është një burim i pasur me vitaminë C, folat dhe fibrë. Ajo ka edhe disa përbërës të rëndësishëm për mëlcinë dhe neutralizon substancat toksike. Lulelakra konsumohet e gatuar me avull, e zier si edhe përfshihet në sallata.

### Hudhra

Lufton inflamacionin dhe kolesterolin. Ajo përmban antioksidantë dhe parandalon mpiksien e gjakut, duke i ardhur në ndihmë veshkave.

Hudhra përdoret në shumë gatime si me mish, perime, peshk dhe salcë domate.

### Qepët

Qepët përmbajnë flavonoidë dhe kuercetinë që parandalojnë depozitim të yndyrave në enët e gjakut. Kuercetina është një antioksidant që mban larg sëmundjet e zemrës. Qepët janë shumë të mira për veshkat dhe kanë pak kalium, e përmbajnë krom që ndihmon në metabolizimin e yndyrave, proteinave dhe karbo-



hidrateve.

### Mollët

Një mollë e vetme është burim i pasur fibre dhe substancash që luftojnë inflamacionin. Ajo largon kolesterolin e keq, shmang konstipacionin dhe sëmundjet e zemrës. Ky frut mund të konsumohet edhe si pije e shijshme.

### Frutat e pyllit

Boronat përmbajnë antioxiandinë, një antioksidant që largon toksinat dhe inflamacionin. Ato përmbajnë vitaminë C, fibrë dhe mangan. Boroniat bëjnë mrekullira edhe për kockat. Mjehra përmban një acid që neutralizon radikalet e lira në organizëm. Luleshtrydhet janë të pasura me antioksidantë, vitaminë C, mangan, fibrë por edhe shumë substancat kundër inflamacionit, që garantojnë shëndetin e zemrës dhe veshkave.



### E bardha e vezës

Përbën proteinën më të pastër dhe më cilësore që mund të gjendet në tokë e përmban aminoacide të rëndësishme dhe pak fosfor që e bën fantastike për shëndetin e veshkave.

### Peshku

Peshku është një burim i pasur proteinash. Rekomandohet që të konsumoni dy ose tre herë peshk në javë. Peshku përmban acidet yndyrore omega-3 që parandalon radikalet e lira dhe sëmundjet e zemrës dhe është i dobishëm kundër kolesterolit të keq dhe rritjes së nivelit të kolesterolit të mirë.

### Vaji i ullit

Vaji i ullit përmban acid oleik që mbron organizmin kundër oksidimit. Për më tepër polifenolët dhe antioksidantët luftojnë inflamacionin dhe mbajnë veshkat të shëndetshme.



## Efektet antioksiduese të çajit të sherbelës

**S**herabela ka aftësi anti-inflamatore, Santloksiduese e anti-mikrobiale, por, gjithashtu, ndihmon në hapjen e orensit. Për shkak të këtyre cilësive, çaji i sherbelës ka shumë veti shëndetësore. Antioksiduesit shërbejnë si pastrues për të hequr radikalet e lira të metabolizimit dhe toksinat e tjera nga trupi dhe ndalojnë radikalet e lira që të sulmojnë indet qelizore, duke ndaluar në këtë mënyrë plakjen e parakohshme dhe rrezikun ndaj sëmundjeve kardiovaskulare apo kancerogjene. Çaji i sherbelës është për këtë arsye një burim i fuqishëm me antioksidantë, që ndihmon për t'i mbajtur larg efektet shkatërruese të radikaleve të lira. Efektet antioksiduese të çajit të sherbelës mund të përmirësojnë funksionet jetësore të mëlcisë. Një studim tjetër i indeve qelizore



zbuloi se ekstraktet e sherbelës parandalojnë shpenzimin e koenzimave të oksidimit, të cilat janë përbërës shumë të rëndësishëm në antioksidimin e mëlcisë me rreth 62%. Problemet e menopauzës reduktohen nga çaji i sherbelës dhe ky zbulim erdhi nga një studim i publikuar në qershor të vitit 2011. Pjesëmarrësit në studim morën çdo ditë një suplement të gjethes së sherbelës për tetë javë. Rezultatet treguan një rënie të afshëve prej 64% brenda tetë javëve, me disa raste të eliminimit të plotë të afshëve. Simptoma të tjera të menopauzës duke përfshirë ato psikologjike dhe urinare gjithashtu u bënë objekt i përmirësimeve. Çaji i sherbelës mund të ndihmojë në reduktimin e ankthit dhe në përmirësimin e humorit. Çaji i sherbelës shkakton kontraktim të traktit urinar dhe këshillohet të mos përdoret tek gratë gjithashtu u bënë objekt i përmirësimeve. Çaji i sherbelës mund të ndihmojë në reduktimin e ankthit dhe në përmirësimin e humorit. Çaji i sherbelës shkakton kontraktim të traktit urinar dhe këshillohet të mos përdoret tek gratë gjithashtu. Sasi të mëdha të sherbelës mund të shkaktojnë kriza, marrje mendsh dhe rrahje të shpeshta të zemrës. Nëse vuani nga diabeti përdoreni vetëm me këshillimin e mjekut. Çaji i sherbelës është shumë i mirë për uljen e temperaturës dhe të ftohtët, për zbutjen e acarimit të fytyrës, dhimbjen e kokës si dhe për problemet e tretjes.

**Bullgaria kërcënon Maqedoninë: Do ju bllokojmë në NATO e BE**

**Ministri bullgar: Mos keqpërdorni temën me gjuhën maqedonase, do ju kushtojë anëtarësimin**

Maqedonia mund të bllokohet nga Bullgaria në procesin e integritimit euroatlantik, nëse tenton të keqpërdorë temën me gjuhën maqedonase, ka deklaruar Krasimir Karakaçanov, zëvendëskryeministër për siguri dhe njëherësh ministër i Mbrojtjes i Bullgarisë. "Zoti Zaev, mos e keqpërdorni temën me gjuhën maqedonase. Kjo mund t'ju kushtojë me anëtarësimin në NATO dhe BE", ka theksuar zyrtari bullgar, duke komentuar një deklaratë të një jave më parë të kryeministrit të Maqedonisë, Zoran Zaev se "Mar-rëveshja e Prespës vërteton ekzistimin e gjuhës maqedonase dhe se askush më nuk do të ketë të drejtë që këtë ta kontestojë", tha ministri bullgar. Ministri bullgar i



Mbrojtjes ka thënë se gjuha maqedonase nuk ekziston dhe se nuk do të lejojë që të dikush fshehtas të aplikojë një gjuhë të tillë. Në një postim në "Facebook", Karakaçanov ka shkruar se "tokat maqedonase

janë bullgare, që është një fakt historik andaj edhe nuk do të lejoj kompromise me historinë e Bullgarisë". "Maqedonia e Veriut është emërtim gjeografik që përfshin edhe vende terriore të Republikës

**KRASIMIR KARAKAÇANOV**

"Zoti Zaev, mos e keqpërdorni temën me gjuhën maqedonase. Kjo mund t'ju kushtojë me anëtarësimin në NATO dhe BE. Marrëveshja e Prespës vërteton ekzistimin e gjuhës maqedonase dhe se askush më nuk do të ketë të drejtë që këtë ta kontestojë" - tha ministri i Brendshëm bullgar.

së Bullgarisë. Zaevi nesër mund të dëshirojë një dialekt të ngjashëm bullgar që të mësohet si gjuhë zyrtare e huaj te ne. Kjo është e pa-pranueshme. Ky është provokim", ka theksuar ministri bullgar. Sipas tij, historia e Maqedonisë së sotme është e përbashkët me atë të Bullgarisë deri në vitin 1944, andaj edhe ka kërkuar aneks në marrëveshjen e fqinjësisë së mirë që pala maqedonase të pranohet këtë si fakt. "Nëse këtë e kundërshtojnë, nuk do ta marrin mbështetjen tonë për në NATO dhe BE. Nuk do të lejoj kompromise me historinë tonë", ka shkruar Krasimir Karakaçanov, zëvendëskryeministër dhe ministër i Mbrojtjes i Bullgarisë, raporton REL.

**SHKURT**

**Vuçiç: Ndërkombëtarët s'po reagojnë për masat e reja të Kosovës**

Presidenti serb Aleksandar Vuçiç ka thënë dje se Kosova është e gatshme të aplikojë masa të reja ndaj Serbisë, duke thënë se bëhet fjalë për tri masa të ndërtira që mund të ndërmerren, por pa treguar se për çfarë bëhet fjalë. I pyetur nga gazetarët nëse ka vlerësime se çfarë veprimesh të tjera mund të ndërmerren Prishtina, pas aplikimit të takses 100 për qind, Vuçiç tha se "bëhet fjalë për tri veprime të cilat do të mund të përpigjen t'i ndërmerren dhe nuk dihet se cila është më e keqe se tjetra për ne". "Por, unë nuk mendoj se ndonjë prej këtyre gjërave është e mirë në periudhë afatgjatë për Haradinajn. Ai është që i shikon gjërat në afat të shkurtër, sikurse edhe disa nga kundërshtarët tanë politikë. Shumë në afat të shkurtër i shikojnë gjërat", tha Vuçiç, përcjell Telegrafi. Siç raporton "Tanjug" serb, Vuçiç deklaroi se shtoi se shteti do të marrë vendime lidhur me masat e reja të Kosovës vetëm kur atëherë kur të ndërmerren nga pala kosovare. "Mendoj se është e rëndësishme që ne të tregojmë rezistencë dhe kundërshtim të qëndrueshëm dhe të fortë, por gjithmonë të qetë, ndaj masave të tilla. Por do të shohim se çfarë do të ndërmerren dhe në përputhje me atë do të marrim vendime", tha Vuçiç.

**Gazeta "Danas": Kongresmenë e senatorë kanë marrë para nga zyrtarë kosovarë**

**Shpërthen Serbia: Kadri Veseli blen në Amerikë 4 mld dollarë armë**

*Media serbe: SHBA-të e konsiderojnë Kosovën partner strategjik*

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e konsiderojnë Kosovën partner strategjik është titulli nga gazeta serbe "Danas", referuar burimeve diplomatike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë artikull përmendet edhe vizita e fundit e presidentit Thaçi në SHBA, pjesëmarrja e tij në varrimin e ish-presidentit Bush, si dhe fakti që ai ishte ulur afër liderëve më të rëndësishëm botërorë. Sipas burimeve të kësaj gazete, raportet e mira mes SHBA-ve dhe Kosovës në planin diplomatik, janë më së shumti të shtyra nga senatorët Bob Dole, si dhe kongresisti Elliot Angel. "Cilido nga përfaqësuesit e Prishtinës të merrte pjesë në funeralin e Bush, do të ulëj në të njëjtin vend që është ulur presidenti Thaçi, ngaqë shqiptarët e Kosovës kanë marrëdhënie të shkëlqyeshme me SHBA-të për vite të tëra, si rrjedhojë e lobimit të suksesshëm", thuhet nga këto burime. Megjithatë, sipas të njëjtave burime, nuk kanë munguar as rastet kur kongresmenë dhe senatorë janë shpërblyer me para nga zyrtarë të Kosovës. Sipas tyre, në këtë aspekt ka kontribuar edhe diaspora shqiptare në Amerikë. "Diaspora shqiptare është shumë e fuqishme dhe nuk ka kursyer asgjë për të ashtuquajturat çështje shtetërore", thuhet nga këto burime. Kujtojmë se përveçse në funeralin e ish-presidentit amerikan, Thaçi ishte ulur në mesin e liderëve botërorë edhe në ceremoninë që shënon përfundimin e Luftës së Parë Botërore që ishte mbajtur në Francë. Kjo kishte shkaktuar reagime të njëpasnjëshme në Serbi. Gjithashtu, mediat serbe po merren intensivisht me zhvillimet në Kosovë, sidomos me ato që kanë të bëjnë me ushtrinë. Vizita e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli në SHBA, i ka "çmendur" fare serbët. Media serbe shkruan se "njeriu më i fu-



Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli

qishëm nga Prishtina" ka shkruar në Amerikë për të blerë armë për Ushtrinë e Kosovës. "Veseli e ofron Trepçën për 4 miliardë dollarë", është titulli i gazetës serbe. Sipas kësaj gazete, Kosova është e gatshme që pasurinë minerare dhe energjetike t'ia jap Amerikës për armë. "Për për-gatitjen, armatimin dhe blerjen e sistemit antiraketor "Patriot", Prishtina është e gatshme që amerikanëve t'ua jap pasurinë minerare dhe energjetike", shkruan tutje media. Kjo gazetë po ashtu ka botuar

edhe një letër të ish-Presidentin George Bush, sipas të cilës qysh në vitin 2008 ia ka miratuar ndihmën ushtarake Kosovës. Ndërkaq, gjatë qëndrimit në SHBA, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli ka vizituar Gardën Kombëtare të Iowas, ku ka parë nga afër mënyrën e organizimit dhe ka diskutuar me ta për mbështetjen që i është dhënë deri më tani FSK-së. "Ushtria e Kosovës është e paqes, e NATO-s dhe është kontribuuese e stabilitetit në rajon, ajo do të jetë pjesa më krenare

**GAZETA SERBE "DANAS":**

"Cilido nga përfaqësuesit e Prishtinës të merrte pjesë në funeralin e Bush, do të ulëj në të njëjtin vend që është ulur presidenti Thaçi, ngaqë shqiptarët e Kosovës kanë marrëdhënie të shkëlqyeshme me SHBA-të për vite të tëra, si rrjedhojë e lobimit të suksesshëm", është shkruar nga burimet në gazetën "Danas"



**Sulmet kundër negociatorit për Kosovën, opozita serbe: S'ka liri**

Ditën e djeshme opozita serbe është takuar aty ku takohet ajo kundër Sllobodan Milloseviçit. Në sheshin e Fakultetit Filozofik, opozita thotë se nuk ka liri. Ata u mbledhën pas sulmeve që ndodhën kundër ish-shefit negociator për Kosovën, Borko Stefanoviç. Presidentin serb, Aleksandar Vuçiç, e quajten tradhtar, hajdut, bandë e përgjakur. "Më vjen mirë që jeni këtu dhe jo në shtëpi, në Facebook apo Twitter. Dua ta pyes këtu Aleksandar Vuçiç, edhe sa koka njerëzish dëshiron t'i thesh për të qëndruar në pushtet edhe sa këmisha dëshiron t'i përgjakësh? Kjo do të kalojë, jam shumë i bindur". Mbi 10 mijë persona marshuan drejt televizionit publik pasi opozita kurrë nuk ftohet në shumicën e mediave. Një pjesë e tyre nuk raportuan për ngjarjen, por për protestat në Francë. Opozita serbe, e majta dhe nacionalistët, janë bërë bashkë në një koalicion të quajtur "Lidhja për Serbinë".

e Kosovës, dhe do të jetë në partneritet me aleatët tanë", tha Veseli në një intervistë për RTK. Sipas tij përvoja e Ushtrisë Amerikane do të jetë në Ushtrinë e Kosovës. "Kjo vizitë është e jashtëzakonshme, Grada e Iowas, është ndihmesë për Kosovën. Nga vizita jonë del mesazhi që kjo ushtri është e paqes, kemi garancinë e SHBA-së. Të gjithë ata zëra që janë skeptik, le ta harrojnë. Ushtria jonë do të fuqizohet, sepse është në krah me SHBA-në", tha ai.



Gazetari vjen me një roman interesant: E dhimbshme si humbi ai vend

# 'Broadway i Tiranës', si jetohej në rrugën e famshme...

## Bedri Alimehmeti: Vendi ku mblidhej "Samiu" dhe futbollistët e Tironës




Rezarta Delisula

Ajo ishte rruga më e bukur në Tiranë, jo sepse kishte ndonjë objekt historik me shumë vlera, apo vitrina shumëngjyrëshe, por kishte plot të rinj, mbushur me dëshirën për të jetuar mirë, e që njihnin botën përmjet Adriatikut mes librave që i kalonin dorazi. Aty lindnin miqësi, dashuritë mes të rinjve, rriteshin shpresat... Po flasim për 'Broadway'-n e Tiranës, që gazetari e publicisti Bedri Alimehmeti ka sjellë në lexuesit, treguar në një formë të thjeshtë, mbushur me emra e data, personazhe realë të asaj rruge rinore.

### Si lindi libri 'Broadway' i Tiranës?

Jo e rastësishme që lindra e tij. Gjithsesi duhet thënë se, fillesa e librit është ajo poezi e shkurtër me titull "Djemtë e Broduejt", të cilën e kisha shkruar në ato vite të largët dhe që tashmë është në libër. Faktikisht e pata harruar, aq më tepër që në atë kohë ishte e pabotueshme e madje po të të gjendej do kishte pasoja. Kështu kishte mbetur ajo poezi harruar nëpër letrat e mia. Ndërkohë në vitin 1993 në 30-vjetorin e maturës së parë dalë nga gjimnazi "Sami Frashëri", shokët më ngarkuan të mbaja fjalën e rastit, ku ndër të tjera përmenda 'Broduejn', të cilin për shkak të vendndodhjes në arinim ta "shkelnim" me shumë. Pas kësaj një ditë teksa sistemoja në të tryezën e punës më ranë në dorë letrat e fjalës që kisha mbajtur. E lexova dhe menjëherë u ula në makinën e shkrimt, nga ku u ngrita vetëm pasi kisha përfunduar kapitullin e parë që tashmë është në libër. Po atë ditë e dërgova në një periodik letrar (ishin të shumtë në vitet e parë të pluralizmit), ku të nesërmen u botua. Më qe shokë pasi e lexuan më nxitën të vazhdoja. Dhe unë vijova ta shkruaj "Broduejin e Tiranës", fragmentet e të cilit i kam botuar herë pas here. Madje në libër kam qartësuar arsyet e vonës së botimit të librit, që është i 19-të në radhën e librave që mbajnë firmën time.

**Kujti i adresohet ky libër?**  
Sigurisht i drejtohet djemve dhe vajzave jo vetëm të Tiranës të viteve 60-të të shekullit të kaluar, tashmë në moshë mbi 65 vjeç, disa prej të cilëve nuk janë më, të tjerë kanë emigruar, pa harruar që janë bërë gjyshër e gjysha. Pa dyshim që u drejtohet edhe të rinjve të sotëm, për të mësuar e ditur më shumë për jetën e prindërve të tyre, që edhe pse në kushtet e të jetuarit e shkollimit në një vend diktatorial, izoluar totalisht nga bota



Hyrja në rrugën 'Broadway'

perëndimore, arritën të ia dinin mbanë, të ecnin në të njëjtin hap me bashkëmoharëtarët e tyre në Europë e në SHBA, të cilët guxuan të sfidojnë diktatorin në forma të ndryshme, e deri me emërtimin e rrugës, ku ata kalonin mbrëmjet. Ndaj jo më kot librin ua kam dedikuar dy vajzave të mia Albës dhe Eralës.

### Si u bë kjo rrugë, 'rruga e rinisë'?

Krejt natyrshëm. Më lart thash që në ishim maturantët e parë të "Samit", tre vitet e parë të gjimnazit i patëm kryer të "10 Korriku" sot "Sinan Tafaj", përpos që si shumë të tjerë edhe banonim jo shumë larg, pra në mëhalat rrotull saj. Aty mblidheshin miqtë e shokët tanë futbollistët e Tironës, të cilët diku aty të "Vjosa" kishin magazinën e furnizimit me materiale sportive, si dhe pas



Djemtë e Broadway në vitet 60 ulur te vitrinat e dyqanit të luleve

stërvitjeve mblidheshin te dyqani i profesorit të tyre seleksionerit të njohur Xhavit Demneri, aty afër ishin reklamata e kinemave, teatrit, operës, estradës etj., ishin pasqeritë, birraritë, MAPO e madhe, pa harruar që ajo rrugë ishte arteria kryesore ku derdeshin djemtë e pashëm e vajzat e bukura nga

të katër anët e Tiranës, nga ku nisnin xhiron e famshme tashmë të harruar të Tiranës. **Personazhet në të janë realë e kjo e bën shumë interesante. A kanë nisur komentet e para?**  
Sigurisht që kanë nisur. Përgjizimet e urimit e parë m'i kanë dhënë shokët e miqtë e mi të atyre viteve të



Autori Bedri Alimehmeti

paharruar, të cilët janë personazhe në libër. Dhe domosdo reagimet e tyre më bënë të ndihem mirë. Madje, bashkëshortja e njërit prej tyre, që e kishte lexuar librin me një frymë, më tha se gjatë leximit ishte përlotur disa herë. Natyrisht ky fakt më emocionoi jo pak. Ndërkohë dua t'u drejtohem me këtë mesazh lexuesve: **MERRENI LIBRIN TIM LEXOJENI, POUNUK JU PËLQEU MA SILLINI UNË JU KTHEJ PARATË DHE JU JAP NJË KAFE.**



Broadway në vitet '60

viteve. Apo dy Gitat e Tiranës etj.

**Po revolta?**  
Kam përmendur diçka në lidhje me "goglat përplasëse", që u ndaluan nga policia. Por më së shumti brodueistët revoltën e tyre e shprehnin në shkallët e stadiumit e të palatit të sportit kur luante Tirona. Ndonëse jo pak prej tyre edhe janë ndëshkuar. Në ato vite regjimi diktatorial ishte në kulmin e egërsisë së tij.

**Si u shpërbë Broadway?**  
E dhimbshme. Për të ardhur keq. Nuk di ç'të them. Nisi me gropën e famshme, vijoi me rrafshimin e MAPO-s, e me radhë rreth 75 % të ndërtesave në të dy anët e saj nuk janë më. 'Broduej' nuk ka më dalje në sheshin "Skënderbej". Tirona ka humbur një pjesë të rëndësishme madje dukurin vërtet më origjinale në memorien e saj.

**Nostalgji apo trishtim për atë çka humbën të rinjtë e aso kohe. Si do e përcaktoni?**

Të dyja bashkë. Domsdoshmërisht duhet përjetësuar në një obelisk a pllakë perkujtimore

**A ka sot një 'Broadway' Tirona?**

Në Tiranë jo më. Për të ardhur keq. Më dhemb në shpirt

**BEDRI ALIMEHMETI**

**BRODUEJ I TIRANËS (BROADWAY OF TIRANA)**

ISSN: 1857-1000

Qmimi: 1000 lekë

**Bedri Alimehmeti** (1948 - ) është një shkrimtar shqiptar. Ka shkruar romanet "Brodueji i Tiranës" (2014) dhe "Samiu" (2018). Është i njohur për veprat e tij të tilla si "Djemtë e Broduejt" dhe "Samiu".

**Bedri Alimehmeti** (1948 - ) është një shkrimtar shqiptar. Ka shkruar romanet "Brodueji i Tiranës" (2014) dhe "Samiu" (2018). Është i njohur për veprat e tij të tilla si "Djemtë e Broduejt" dhe "Samiu".

Opinion i Ditës

# Jo Pons Pilatin me studentët!

Nga Fatos Çoçoli

(vrijon nga faqja 1)

...duarsh. Premtime (imzot fjalë, o sa shumë fjalë!) për të kaluar lumin. Kërkesat studentore janë të qarta. Disa të realizueshme, të tjerat duan një hark kohor shumë të gjatë (për shembull, të dyfishosh paratë për arsimin do të thotë që, për shembull, për vitin që po vjen 2019-ën të japësh nga 282 milionë euro që Buxheti i Shtetit ka parashikuar e miratuar, në afro 600 milionë euro!). Me shumë maturi studentët nuk formojnë përfaqësi dhe u bëjnë thirrje intelektualëve të vendit t'i mbushin me argumente bindës kërkesat e tyre. Ata thjesht e ndjejnë se çfarë kërkojnë është e drejtë. Nuk dinë rrugën për t'i realizuar. Mes të drejtës legjitime dhe gati të shenjtë të tyre për një jetë më të mirë në kampuset universitare dhe për arsimim publik të lartë dinjitoz dhe qeverisë, qëndron profesorati gjysmë i korruptuar dhe treçerek abuzues i universiteteve publike. Si dhe trupa menaxhuese krejtësisht e paafte dhe e papërgjegjshme e këtyre universiteteve. Qeveria ka në dorë një mekanizëm që nuk po funksionon fare, me "qeverinë" e arsimit të lartë të nënsatet e universiteteve). Deri tani qeveria ka bërë spektatoren. Studentët po i protestojnë të dritarja për të marrë përgjegjësitë e saj. Dhe qeveria duhet të tregohet e përgjegjshme. Nisma e parë e menjëhershme duhet të jetë që të përmirësojë ligjin Nr. 80/2015 (për të cilin mburret se është mjaft i arrirë), duke futur në të shërbimet studentore si koncept dhe si program i detyrueshëm për zbatim (ky ligj nuk ka asnjë fjalë për to!). Shërbimet studentore (kujdesi shëndetësor, këshillat juridike, shërbimet për gjetjen e punëve sezonale gjatë të qenit student, për orientimin në punësim tek ata që përgatiten të diplomohen, etj, etj.) janë lënë në mëshirë e fatit dhe askush nuk përgjigjet as për mungesën e tyre, as, atëherë kur jepen, për cilësinë mjerane dhe papërgjegjshmërinë ek-



stre me një bërthamë 20-25 profesionistësh që trajnohen për më shumë. Të kërkojë ekspertë të

streme të atyre që e japin. Të fushës së shërbimeve studentore si trajnues për nxënësit e akademisë. Qeveria mund të dyfishojë

grantin (pagesën pa kthim nga Buxheti) për kërkimin shkencor nga 366 milionë lekë (2.95 milionë euro) të vitit akademik 2017-2018 në 6 milionë euro për pjesën që ngelet nga ky vit. Dhe të shikojë me kujdes strukturat që do ta përdorin këtë fond, sepse deri tani është keqpërdorur. Kërkimi shkencor i mirëfilltë i aftësion studentët të gjejnë punësim dinjitoz për të ardhmen e tyre. Qeveria ka shumë për të bërë, në rast se kërkon realisht t'i ndihmojë studentët. Ta nisë me një përgjigje zyrtare shkresore, njëllësi e kanë kërkuar studentët në shkresën e tyre me shkrim dore, ku të japë një përgjigje të sinqertë e të detajuar për të tetë kërkesat e tyre. Kjo bëhet tani (për shembull, përgjysmimi i tarifave shkollore të tanishme do t'i kushtojë qeverisë vetëm 13 milionë euro grant në vit-duke filluar nga janari 2019- për të 16 universitetet publike, pasi 3.1 miliardë lekë ose 25 milionë euro janë të ardhurat që këto universitete sigurojnë nga vjelja e tarifave). Përmirësimi i kushteve të jetesës në kampuse bëhet tani dhe në vijim. Marrja seriozitetit e listës së studentëve me emrat e pedagogëve që marrin rryshfet për provimet, përse jo, duke e zgjeruar atë me denoncime të tjera studentësh e prindërish të tyre, duke ngritur një grup pune të posaçëm (apo nuk i ka qejf kjo qeveri task forcat!) inspektorë të Ministrisë së Arsimit me inspektorë të Drejtorisë së Krimit Ekonomik, duke kallzuar edhe penalisht ata pedagogë, kur prindi dhe studenti bien dakord të hedhin firmën mbi denoncimin e tyre. Ndërkohë, qeveria në po këtë shkresë të shprehet se dyfishimi i parave për arsimin bëhet në një periudhë 8-12 vjeçare dhe kërkon një strategji të qartë e me veprime konkrete se ku do të investohen këto para të shtuara. E kështu me rradhë. Po nuk e bëri këtë, edhe dialogu kryeministrit i sotëm me studentët nëpërmjet rrjetit social "Facebook" do t'i ngjajë trukeve të shumta të "dëshirëmirave qeveritare" me të cilat na ka përmblytur kjo qeveri-OJF gati virtuale.

grantin (pagesën pa kthim nga Buxheti) për kërkimin shkencor nga 366 milionë lekë (2.95 milionë euro) të vitit akademik 2017-2018 në 6 milionë euro për pjesën që ngelet nga ky vit. Dhe të shikojë me kujdes strukturat që do ta përdorin këtë fond, sepse deri tani është keqpërdorur. Kërkimi shkencor i mirëfilltë i aftësion studentët të gjejnë punësim dinjitoz për të ardhmen e tyre. Qeveria ka shumë për të bërë, në rast se kërkon realisht t'i ndihmojë studentët. Ta nisë me një përgjigje zyrtare shkresore, njëllësi e kanë kërkuar studentët në shkresën e tyre me shkrim dore, ku të japë një përgjigje të sinqertë e të detajuar për të tetë kërkesat e tyre. Kjo bëhet tani (për shembull, përgjysmimi i tarifave shkollore të tanishme do t'i kushtojë qeverisë vetëm 13 milionë euro grant në vit-duke filluar nga janari 2019- për të 16 universitetet publike, pasi 3.1 miliardë lekë ose 25 milionë euro janë të ardhurat që këto universitete sigurojnë nga vjelja e tarifave). Përmirësimi i kushteve të jetesës në kampuse bëhet tani dhe në vijim. Marrja seriozitetit e listës së studentëve me emrat e pedagogëve që marrin rryshfet për provimet, përse jo, duke e zgjeruar atë me denoncime të tjera studentësh e prindërish të tyre, duke ngritur një grup pune të posaçëm (apo nuk i ka qejf kjo qeveri task forcat!) inspektorë të Ministrisë së Arsimit me inspektorë të Drejtorisë së Krimit Ekonomik, duke kallzuar edhe penalisht ata pedagogë, kur prindi dhe studenti bien dakord të hedhin firmën mbi denoncimin e tyre. Ndërkohë, qeveria në po këtë shkresë të shprehet se dyfishimi i parave për arsimin bëhet në një periudhë 8-12 vjeçare dhe kërkon një strategji të qartë e me veprime konkrete se ku do të investohen këto para të shtuara. E kështu me rradhë. Po nuk e bëri këtë, edhe dialogu kryeministrit i sotëm me studentët nëpërmjet rrjetit social "Facebook" do t'i ngjajë trukeve të shumta të "dëshirëmirave qeveritare" me të cilat na ka përmblytur kjo qeveri-OJF gati virtuale.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ





Opinioni **i** Ditës

# Një lëvizje e re studentore me përgjegjësi historike apo...

Nga Sulejman Mato

(vijon nga faqja 1)

...ndodh 28 vjet me vonesë. Pas përmbyesjes së sistemit të ashtuquajtur socialist rinisë studentore iu desh të flinte një gjumë për 28 vjet, e qetë e ndrydhur dhe pa asnjë ndjenjë qytetarie. Një pjesë e saj ikën jashtë atdheut, të tjerët shihnin dhe vazhdojnë të shohin se si, për çdo ditë e për çdo vit rritet gjëma e shkakuar nga kaosi i liderëve të rinj dhe ligjeve të reja, të cilët e shkatërruan këtë vend e sakatuan jo më pak njeriun që prishte lindjen e demokracisë...

E përshëndes me gjithë zemër këtë rini të re shqiptare dhe këtë nismë të re, e cila fillimisht duket kaotike dhe pa qëllime të larta, pa lider dhe për më tepër, pa vizion... E rëndësishme është t'ju themi, në qoftë se keni dalë rastësisht në shesh, vetëm për të realizuar disa kushte studentore, kthetuni sa më parë në shtëpitë tuaja dhe në kafenet tuaja të preferuara, pasi, paratë që ju kërkoni për një arsimim falas duhet t'ia kërkoni sistemit të kaluar. Në sistemin e ri demokratik nuk ka studime falas, dhe as që ka nevojë për një ushtri kuadrosh të ardhshme, por pa vende pune. Imagjinoni dhe ju, janë 160 mijë studentë që studiojnë sot, brenda dhe jashtë vendit, dhe nuk ka asnjë planifikim për punësimin e tyre. Problemi kryesor që ka rinia sot është punësimi pasuniversitar ose largimi përfundimtar nga vendi i tyre.

Problemet e reformës arsimore në vendin tonë janë të agravuara nga viti në vit, të mëdha dhe të shumëanshme. Ka tre vjet që nuk reshitin vërejtjet për përmirësimin e jetës studentore, për tekste të dobët, dhe mësimdhënie të dobët. Kështu që, dhe perspektiva e kërkesave tuaja, të cilat ju sot i quani të rëndësishme, nuk kanë ndonjë vlerë për të ardhmen tuaj... Lëvizja studentore është pritur nga ne si uji i pakët, jo për të ndryshuar jetën studentore, por, për të ndryshuar diçka në këtë vend...

Dhe ja, më së fundi ajo lindi, përmes kaosit dhe përmes disa kërkesave të cilat vijjnë gjithmonë në rritje pritet të ndodhë diçka e re. Dy pyetje të rëndësishme dalin sot përpara kësaj lëvizjeje studentore. E para, gjer ku do të shkoni... dhe sa i gjatë është hapi juaj? Së dyti, a jini ju vërtetë ata që do t'u ngjani studentëve të dhjetorit të nëntëdhjetës, të cilët sollën ndryshimin? Nëse lëvizja juaj do të jetë brenda kërkesave të një lëvizjeje studentore, fundi i kësaj lëvizjeje duket i shpejtë, fitorja juaj do të ishte vdekja e iluzioneve për një jetë të re dhe për një të ardhme të re... Në një shkrim në f.b. lidheri i studentëve të dhjetorit nëntëdhjetë, Shenasi Rama, profesor uni-



versiteti në Amerikë, shtron para lëvizjes suaj dhjetë pikëpyetje. Në fund ai thekson: "Ashu si të silleni ju (me këtë lëvizje) ashtu do të jetë dhe brezi i ardhshëm nesër". Shkrimtari i njohur Bedri Zenel Islami për lëvizjen tuaj studentore nënvizon: "Nëse kjo lëvizje nuk do të ketë pikësynime afatlargëta dhe e mbështetur nga populli, nuk do të kishte asnjë kuptim." Liderët e lëvizjeve dalin në çaste historike, ndaj dhe unë pres me padurim që midis këtyre studentëve dhe studenteve kaq të gjallë ta dalin student idealist, me ide të qarta, e cila do të shndërrohet në një lëvizje politike me mbështetje nga populli. Lëvizja juaj duket një lëvizje sektare. Mospjesëmarrja dhe mospranimi i shtresave të gjëra popullore është një gabim i pafalshëm. Përzënia e protestuesve të Unazës së Re të cilët vijjnë për t'ju mbështetur me përgjegjësi qytetare ish të gabimi i parë. Në fund të fundit, siç dhe u shpreh një nga protestuesit e Unazës së re, "ata vijjnë tek ju se mbështesim fëmijët e tyre" se dhe vet një nga ata kishte vajzën

student, midis jush. Një lëvizje serioze me qëllime të caktuara, të lagëta, por me shkëputje nga masat dhe pa solidaritetin e masave do të ketë një fund të trishtë. Të dashur studentë, ju jini pjesa e gjallë intelektuale e një populli, ju jini e vetmja shpresë për një ndryshim të ri. Me lëvizjen tuaj rinore, me kërkesa të qarta për ndryshime radikale ju sigurisht do të sillni një frymë të re në politikën 28-vjeçare, e cila i ka sjellë shumë dëme këtij vendi... Nëse lëvizja juaj merr karakter politik, madje, nëse ju, ashut si studentët e dhjetorit të vitit nëntëdhjetë, do të krijoni një parti të re, unë do të jem i pari që do të zbris në mesin tuaj dhe do të marshoj mes jush përpara kryeministrit, si dikur në dhjetorin e atij viti të stuhishëm. Tashmë që po shkruaj këto radhë më kujtohet dhjetë dhjetori i vitit 1990. Atë ditë isha dhe unë midis studentëve që brohorisnin, kundërshtonin qeverinë dhe kërkoni të drejta e tyre studentore. Isha dhe unë midis tyre si

dëshmitar dhe protagonist si entuziast dhe dyshimtar. Isha dhe unë një ndër ata, firmëtar për krijimin e një partie të re studentore. Mirëpo, në fytyrat e asaj rinie kishte shumë më tepër flakë zemërimi dhe shumë më tepër idealizëm... Tek shoh këtë rini të re protestuese, edhe pse më lind dëshira dhe shpresa për ndryshime, vërej një rini ndryshe. Ajo rini e nëntëdhjetës kishte shumë më tepër arsyeshmë më tepër idealizëm, ishin më të përvuajtur dhe më të bashkuar dhe kishin shumë më tepër motivim për krijimin e një partie të re studentore. Sipas mendimit tim kjo lëvizje e re studentore do të përfundojë pa rezultate të dukshme, pasi nuk ka program, as pikësynime afatlargëta as harmoni midis anëtarëve të saj... Thirrja "Ne jemi të gjithë studentë!" nuk të thotë asgjë. Bashkimi i tyre duket si një bashkim interesash të vogla, të rastësishme. Kjo lëvizje nuk ka kauzë të vërtetë... Pritet një lëvizje tjetër, më e pjekur, më idealiste dhe më mbarë popullore.

## HOROSKOPI

**DASHI**  
isa persona të kësaj shenje do të jenë shumë të ashpër gjatë komunikimit me kolegët në punë. Ka gjasë që nga një grup miqsh që keni qenë më parë të ktheheni në armiq, pasi do të mësoni disa informacione të rëndësishme. Ndërsa jashtë pune, ju presin momente shumë të lumtura.

**DEMI**  
Gjatë ditës së sotme do të merrni lajme të mira. Bëhet fjalë për shëndetin e një familjarit tuaj. Edhe në aspektin personal, gjërat do të ecin pozitivisht. Ndërsa sa i përket aspektit profesional, duhet të punoni gjithnjë e më shumë për të arritur rezultatet që doni.

**BINJAKET**  
Binjakët duhet t'i përkushtohen punës sot dhe të mos shpërndrohen nga asgjë. Sukseset në karrierë varet vetëm nga ju. Ka gjasë t'ju rritet rroga. Në jetën personale do të jeni në harmoni. Pasditë mund të bëni disa blerje të vogla.

**GAFORJA**  
Disa persona të kësaj shenje do të përballen me ndenja të çregullta. Një nga arsytet për këtë mund të jetë një debat në mëngjes me partnerin/partneren. Mund të lodheni shpejt në punë, çfarë nuk do të sjellë rezultate të mira për ju.

**LUANI**  
Sot do të tregoni fuqinë tuaj më të madhe. Mund të bëni një plan strategjik për t'i shpëtuar krizës financiare. Sa i përket aspektit personal, gjërat nuk do të shkojnë siç duhet. Ndërsa beqarët e kësaj shenje rrezikojnë të hapin një plagë të vjetër sot.

**VIRGJERESHA**  
Do të kaloni një ditë jo me shumë entuziazëm. Më së shumti do të mendoni për ditët e pushimit që iu presin në fundit ose mund të mendoni për një udhëtim. Edhe mbremja nuk do të jetë ashtu sikur e prisni.

**PESHORJA**  
Duhet të tregoheni shumë të kujdesshëm sot me njerëzit që iu rrethojnë. Analizoni çdo fjalë që ata iu thonë dhe pranoi me dinjitet vlerësimet që iu bëjnë. Ndërsa sa i përket marrëdhënies në çift, duhet të tregoheni sa më të sinqertë.

**AKREPI**  
Disa Akrepë kanë diçka që duan të ndryshojnë sot në jetën e tyre të përditshme. Kjo do të ndikojë edhe të njerëzit të cilët ju i konsideroni të afërt. Mos u bëni pesimist dhe mos lejoni këto emocione t'ju udhëheqin.

**SHIGJETARI**  
Do të ndiheni shumë komod gjatë ditës së sotme. Nuk do të keni asnjë problem si në aspektin personal ashtu edhe profesional. Do të kaloni një mbremje fantastike nën praninë e gjymës suaj të zemrës.

**BRICJAPI**  
Bricjapët mund të konfuzohen nga sjellja e disa personave të caktuar. Ka shumë mundësi që dikush t'ju shprehë përqimimin e tij. Nëse nuk keni ndërmend të nisni një lidhje të re, gjeni fjalatë e duhura për ta refuzuar atë duke mos e fyer.

**UJORI**  
Do të kryeni disa shpenzime për shkak të disa problemeve të papritura. Do ta keni të nevojshme të relaksoheni në shtëpi, pasi qëndrimi i gjatë jashtë mund t'ju shkaktojë irritim. Do t'ju duhen këshillat e familjarëve për një çështje të caktuar.

**PESHQIT**  
Do të keni rezultate të kënaqshme në punë. Mëni kënaqësi për veten. Megjithatë, mos harroni t'i jepni vëmendjen e duhur familjes suaj apo partnerit/partneres, përndryshe mund të përballeni me probleme në këtë drejtim.

**TRAJNERI I FLAMURTARIT**

Trajneri i Flamurtarit, Ilir Daja foli për "Supersport" pas ndeshjes së fituar kundër Laçit, ku u shpreh se kjo fitore kishite vlera shumë më të mëdha, duke parë dhe mungesat që kuqezinjtë kishin. Në fjalën e tij, trajneri i skuadrës vlonjate u shpreh: "Kemi startuar me një 17-vjeçar në formacion që e përgëzoi për lojën që bëri, kemi Kale dhe Torasën që nuk janë në formën më të mirë. Alvesh vjen pas dëmtimit dhe Kale nuk luan deri në fund. Do të doja të kisha

**Daja: Shpresoj që pagesat të jepen në kohën e duhur**



kontingjentin në dispozicion se kjo do të rriste rivalitetin brenda grupit e do të jepnin një lloj tjetër performance.

Por t'ia lëmë periudhës së janarit se këta lojtarë kanë thënë që nuk kemi bërë keq. Nuk kam qenë i informuar për financat, por nëse pagesat jepen në kohë e duhur, natyrshëm që edhe lojtarët motivohen. Gjithsesi, jam i bindur se ajo që ka ndodhur çdo vit të Flamurtarit, do të ndodhë edhe këtë vit, se këtu asnjëherë nuk kanë qëndruar pa shlyer pagesat".

**NË RUMANI**

**Lullaku, 11 minuta, por shënon për Astrës**

Azren Lullaku vazhdon të shënojë në kampionatin rumun të futbollit, me skuadrën e Astrës që vijon të marrë rezultate pozitive. Sulmuesi kuqezi nuk e nisi titullar takimin e djeshëm kundër Konkordias, por u aktivizuar në minutën e 79' të takimit. Pavarësisht se luajti shumë pak minuta, numri 10 i Astrës ishte një rrezik konstant për skuadrën e Konkordias, e cila po kërkonte golin e barazimit, pasi deri në ato momente, ndeshja ishte 2-1 në favor të vendasve. Por Lullaku mbylli përfundimisht llogaritë e takimit, duke shënuar golin e tretë për Astrën dhe duke siguruar tri pikët për skuadrën e tij.



**TRAJNERI I KAMZËS**

**Gjoka: Fitorja ndaj Luftëtarit na jep moral**

Ernest Gjoka ka marrë fitoren e parë në krye të Kamzës. Një sukses që i bën shumë punë, duke pasur parasysh problemet me mungesa të shumta titullarësh javë pas javë, apo dhe faktin që arrihet ndaj një rivali direkt në betejën e mbijetesës së Luftëtarit. "Sigurisht që është shumë e rëndësishme, pasi fitorja është ajo që na jep moral dhe energji për të vazhduar përpara. Kemi lojtarë të mirë dhe këto elemente na bëjnë të besojmë për të ardhmen, por kemi shumë probleme me dëmtimet. Futbollistët sakrifikojnë se ka nevojë skuadra dhe dëmtohen sërish, ky është një problem i madh. Duhet të shohim ku jemi dhe të marrim masat e duhura. Kemi më shumë probleme mbrapa, në mbrojtje sesa në sulm. Në futboll, qetësia, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi janë faktorë të rëndësishëm në çdo skuadër për rezultate. Për momentin, ne i kemi këto cilësi dhe shpresoj që të vijmë edhe rezultate të tilla në vijim. Mendoj se ekipi ishte i lodhur dhe u detyruam të bëjmë dy zëvendësime të detyrueshëm, duke i dëgjur të gjitha energjitë dhe duke shtuar riskun e dëmtimeve. Gjithsesi, unë uroj dhe shpresoj që gjërat të jenë mirë për të ardhmen e Kamzës", - tha Ernest Gjoka pas ndeshjes për "Supersport".

Ngji shen skuadrat, tashmë diferenca nga vendi i parë deri në vendin e gjashtë është 10 pikë



Jeton Selimi

**Super Danilo Alvesh, Flamurtari thyen Laçin**

*Kamza fiton duelin e mbijetesës me Luftëtarin*

Mbyllet me fitoren e Flamurtarit java e 16-të e Kategorisë Superiore. Kuqezinjtë mposhtën 1-0 në Vlorë, Laçin e Migen Memellit në një duel të drejtpërdrejtë për zonën europiane. Vendosi gjithçka një supergol i Danilo Alvesh në minutat e fundit të pjesës së parë, për t'i dhënë tri pikët Flamurtarit dhe për ta ngjitur skuadrën e Dajës në kuotën e 25 pikëve, një më pak se Laçi që pozicionohet në vendin e 5-të. Edhe pse kishte mungesa të rëndësishme si ato të Torasës, Bathës dhe Useinit, Flamurtari shfaqti më shumë dëshirë në fushë dhe e meritoi fitoren. Vlonjatët bënë një pjesë të parë pozitive ndërsa në fillimin e pjesës së dytë e dominuan kundërshtarin duke iu afruar në disa raste golit të dytë, por pa ja arritur qëllimit. Në minutën e 88-të shtylla dhe më pas Koliçi i mohuan golin e barazimit skuadrës së Migen Memellit pas goditjes së Altipamarkovskit. Takimi në Vlorë u mbyll i tensionuar pasi në çastet e fundit,



futbollistët e të dyja skuadrave u përplasën me njëri-tjetrin, por për vendasit e rëndësishme ishte marrja e tre pikëve. Kamza mori një fitore "frymëmarrjeje" teksa mposhti me rezultatin mini-

SUPERLIGA		
JAVA E 16-TE		
<b>TE PREMTEN</b>		
Kukësi-Skënderbeu	1-0	
<b>TE SHTUNEN</b>		
Tirana - Kastrioti	4-0	
Teuta - Partizani	1-1	
<b>TE DIELEN</b>		
Kamza - Luftëtarë	1-0	
Flamurtari - Laçi	1-0	
<b>RENDITJA</b>		
Skuadra	N	P
Partizani	16	35
Skënderbeu	16	30
Kukësi	16	30
Teuta	16	29
Laçi	16	26
Flamurtari	16	25
Tirana	16	14
Luftëtarë	16	13
Kamza	16	12
Kastrioti	16	10

mal 1-0 Luftëtarin e Gjirokastrës në sfidën e luajtur pasditen e djeshme në stadiumin e saj. Mjaftoi një gol i shënuar nga mesfushori anësor japonez Masato Fukui në pjesën e parë, për t'i dhënë 3 pikët skuadrës së Gjokës, që la fundin i tabelës për të shkuar një pozicion më lart. Mesfushori japonez tentoi dy herë brenda pak minutash me kokë, por, nëse në rastin e parë nuk arriti të godasë, në të dytin gjeti kohën e duhur për krosimin e ardhur nga këndi dhe shtyu në rrjetë topin. Nga ana tjetër, Luftëtarë i Mezanit u zgjua vetëm në pjesën e dytë dhe i shkoi pranë golit në 2-3 raste, por pa arritur të thyejë portierin Ilir Avdyli, i cili ishte në gatishmëri të plotë.

**NË ITALI**

**Berisha e Gjimshtiti fluturojnë, Veseli fiton**

Me Etrit Berishën në portë dhe Berat Gjimshtitin që nuk ishte as në stol, Atalanta mori një fitore shumë të rëndësishme brenda në Dacia Arena përballë Udineses me rezultatin 1-3. Duvan Zapata ishte heroi i miqve, ish-lojtari i bardhezinjëve nga Friulli ishte autori i të tre golave për Atalantën që me këtë sukses u ngjiti përkohësisht në vendin e 6-të të renditjes, ndërkohë që Etrit Ber-


isha bëri një paraqitje shumë të mirë dhe nuk kishte asnjë lloj përgjegjësie në barazimin provizor të Udineses që mban firmën e Lassagnas në minutën e 12-të. Me Frederik Veselin titullar dhe që u ndëshkua edhe me karton të verdhë Empoli vazhdoi serinë e rezultateve pozitive duke mposhtur 2-1 Bolognan në shtëpi. Filippo Inzaghi tashmë rrezikon ndjeshëm shkarkimin nga stoli kuqelub ndërkohë që

Beppe Iachini në 4 javë me Empolin ka grumbulluar 10 pikë duke bërë mrekullinë pasi në 11 javë me Andreazzoli në stol skuadra toskane grumbulloi vetëm 6 pikë. Në suksesin e Empolit realizuan dy sulmuesit Caputo dhe La Gumina ndërsa për Bolognan barazoi provizorisht Andrea Poli. Përfundoi në barazim 1-1 ndërkohë sfida tjetër e orës 15:00 mes Parmës dhe Chievos.

**NË GREQI**

**Kaçe shënon gol me kokë, Panathinaikos humbet**


Mesfushori i Shqipërisë, Ergys Kaçe po kalon një moment të shkëlqyer në karrierën e tij dhe forma e mirë e tij do pasqyrohet edhe në fushën e lojës. Futbollisti kuqezi pati shënuar një gol deri më tani në kampionatin grek, një "perlë" kundër Olimpiakosit. Në takimin e djeshëm kundër OFI Kretës, Kaçe shënoi golin e barazimit për Panathinaikos, që po mposhte nga vendasit. Por mesfushori kuqezi përfiton



mjaft mirë nga një krosim i Insua dhe shënon një gol me kokë, duke treguar se gjatësia nuk është aspak problem për të. Edhe pse shtatshkurtër, Kaçe arriti të shënojë golin e dytë në kampionat me kokë, duke i dhënë barazimin provizor të gjelbërve në minutën e 36' të sfidës. Përveç dy golave, Kaçe ka dhe një asist në 8 ndeshje që ka luajtur deri më tani në kampionatin grek të futbollit.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomie e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenjtë.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark biblik.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstremer në numërim.
33. Eshhtë bodrumi.

34. Steiger aktor.
35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonom.
40. Në krye yë evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstremit në litër.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

**VERTIKAL**

1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënnen për t'u bërë i njohur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrrohej nga filibustierët.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informative Tiranë.
21. Një brejtës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipo
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.
34. Neill i Jurassic park.

**VERTIKAL**


35. E bukura e belle epoqe.
37. Qe mbreti i elfëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rockstar
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga morbusi i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor
9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstremer në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërоре
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimize
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lempër, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

7		3			5			
	3		2	9		8		
			4		8			3
	4	1	5			6		9
6			7					
		5		4	6	2		
		8			7		4	
	1	3		5				8
5	2			3		1		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

2	9	4	8	1	3	6	5	7
8	3	6	4	5	7	9	1	2
7	5	1	9	2	6	8	3	4
4	6	9	5	3	2	7	8	1
1	7	3	6	4	8	2	9	5
5	8	2	7	9	1	3	4	6
3	2	5	1	6	9	4	7	8
6	1	8	3	7	4	5	2	9
9	4	7	2	8	5	1	6	3

*Argëtim filozofik*

-Single nuk është një status, është një fjalë që përshkruan një person i cili është mjaft i fortë për të jetuar dhe për të shijuar jetën i pavarur nga të tjerët.

"Kur nuk kisha asgjë për të humbur, kisha gjithçka. Kur ndalova të jem ky që jam, gjeta vetveten"

-Njerëzit që nuk e shprehin qartë se çfarë duan prej jush... zakonisht duan diçka që nuk u përket.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

17	1	8	4	2	4		13	1		13	1
18	3	1	4		18		3		17	13	1
8	1	10	10	10	10	1	3	1	6	12	6
3		1	10	2	5	6	14	1	12	2	4
	13	3	5	4	2	8	4	1	12	4	2
15	9	6	15	1	12	4	6		6	3	3
17	2	4	5	12		2	14		17	5	1
	8	1	7	6		3	1	10	1		2
15	5	12			4	6	4	18	7	7	1
1	3	2	8		1	5			2	12	2
20	19		1	3		20	5	4	6	10	2
6	1		10	2	3	2	12	15	18	2	8

C	R	A	L	K	I	M	I	S	T	I
C	O	S	T	N	E	R	P	A	V	
I	L	R	M	I	I	K	L	A		
R	K	O	P	E	R	N	I	K	U	N
K	O	O	P	E	R	A	T	I	V	A
K	L	I	N	I	K	E	L	F		
T	R	O	K	E	I	R	O	N	I	K
R	S	A	L	T	E	V	I	T	A	
I	T	A	L	I	A	S	E	E	V	A
U	L	E	M	A	R	T	A	C		
M	A	E	J	E	A	N	L	I	J	A
F	U	T	U	R	I	S	T	E	T	A

*Thënie të mençura*

- "Kujtimet, madje edhe më të dashurat dhe më të paçmuarat, në një moment zbehen shpejt, shuhen.
- Por kjo nuk më ndodh mua. Kujtimet e mia, ato kujtime të çmuara dhe të paçmueshme, nuk shuhen".
- Mos e bëj pasionin një argument për të vërtetën.
- Njerëzit që ndërtojnë të ardhmen janë ata që e dinë se gjërat e mëdha ende nuk kanë ndodhur dhe se ata vetë janë ata që do t'i realizojnë.

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQIË TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

H	E	S	A	P	E	T	T	P	A	B	C
E	M	I	R	A	T	E	A	R	A	B	E
L	I	K	E	R	B	E	T	O	N	E	T
E	L	S	A	D	R	I	V	A	L	E	T
N	R	B	U	R	I	M	E	T	J	A	
M	A	R	O	K	E	N	E	O	D	A	T
F	U	L	L	A	N	I	E	M	E	A	
P	L	A	A	T	O	M	I	K	E	A	
A	N	S	T	E	R	E	O	O	L	T	A
P	A	R	S	D	M	A	R	I	A		
A	N	A	N	I	A	P	R	E	S	I	O
S	A	R	D	O	U	D	E	T	I	T	A
P	A	R	A	G	R	A	F	I	V	A	N
I	R	O	N	I	A	O	S	E	R	A	
R	A	B	A	T	B	A	N	A	R	A	
A	M	E	T	A	N	V	R	I	M	A	
T	I	R	T	E	L	E	M	A	K	U	L
S	P	O	L	E	M	I	K	A	E	L	
V	L	K	A	N	A	R	I	N	A	E	N
A	L	V	A	T	I	K	A	N	I	E	N
J	O	E	T	N	E	T	E	M	A		
R	I	M	A	R	A	D	E	T	I	A	
A	R	T	A	N	A	A	R	U	N	I	K
T	A	L	E	N	T	M	A	U	R	I	C

**FJALËKRYQI (2)**

